

## GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P Nr. 459/2009

Prishtinë, 07 shkurt 2011

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Trupin gjykues të përbërë nga:

<b>Gjyqtari i EULEX-it, Z. Ferdinando Buatier de Mongeot:</b>	Kryetari i Trupit Gjikues
<b>Gjyqtari i EULEX-it, Z. Arkadiusz Sedek</b>	Anëtar i Trupit Gjikues
<b>Gjyqtarja nga Kosova, Znj. Hajrije Shala</b>	Anëtare e Trupit Gjikues

Të ndihmuar nga procesmbajtësja, Sonil Macneil, në çështjen penale kundër:

- 1) **Besnik Hasanit**, nofka, "Firaja, i biri i Arifit dhe Nazlijes, data e lindjes, më 20.10.1976, vendi i lindjes, Ferizaj, banor i fshatit Firajë, shqiptar nga Kosova, i martuar, ish zyrtar i PK-së, aktualisht në paraburgim, që nga 21.01.2008, në lidhje me një procedurë tjetër penale.
- 2) **Shpend Qerimi**, i biri i Mustafës dhe Shefkijes, data e lindjes, 18.09.1974, vendi i lindjes, Ferizaj, shqiptar nga Kosova, i martuar, ish zyrtar i PK-së, aktualisht në paraburgim, që nga 21.01.2008, në lidhje me një procedurë tjetër penale.
- 3) **Nysret Cena**, i biri i Isenit dhe Merushës, data e lindjes, më 01.01.1975, vendi i lindjes, Doganaj, banor i Kaçanikut, shqiptar nga Kosova, i martuar, anëtar i SHPK-së.
- 4) **Avket Vishi**, i biri i Idrizit dhe Nakshijes, data e lindjes, 18.06.1966, vendi i lindjes, Gorancë, banor i Gorancës, Komuna e Hanit të Elezit, i martuar, inxhinier.

### TË AKUZUAR PËR

**Besnik Hasani, Shpend Qerimi dhe Nysret Cena:**

#### Pika I.

- 1) *Vrasje e rëndë, e Neshat Baftiut, në kundërshtim me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafët 3, 8 dhe 9, neni 23, i KPK-së;*
- 2) *Vrasje e rëndë e Urim dhe Sylejman Badiut, në kundërshtim me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 3, e lidhur me nenin 23, të KPPK-së, dhe vrasje e rëndë në tentativë e Sadik dhe Bujar Baftiut, në kundërshtim me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 3, e lidhur me nenet 20 dhe 23, të KPK-së.*

**Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi:**

#### Pika II.

*Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2, i KPK-së.*

#### **Avket Vishi**

#### **Pika IV.**

*Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2, i KPK-së.*

Pas mbajtjes së seancave publike dëgjimore, më 16, 17, 18 qershor 2010, 13, 14, 15 korrik 2010, 06, 14, 16, 29 shtator 2010, 21 tetor 2010, 05 dhe 09 nëntor 2010, 31 janar 2011, 01 shkurt 2011, në praninë e Prokurorit të PSRK-së, Z. Reshat Millaku, të të gjithë të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, Mahmut Halimi, Tahir Rrecaj, Avni Ibrahim, Azem Vllasi, dhe avokatit mbrojtës, ex officio, Isak Hoxhës, rikualifikimit të fakteve të përshkruara nga Prokurori publik sikurse në pikat më poshtë, publikisht shpall sikurse më poshtë:

### **AKTGJYKIM**

Në pajtim me nenet 37, 38, 39, 391, paragrafët 1 dhe 2, të KPK-së,

#### **a. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi,**

#### **SHPALLEN FAJTOR**

Sepse, në mes të 00.10-00.15, të natës në mes të 27 dhe 28 shtator 2007, ata e vranë Neshat, Urim dhe Sylejman Baftiun në mënyrë dinake në urën e Lepencit (e vendosur në autostradën, Prishtinë-Shkup e cila çon në fshatin Sopicë). Në veçanti, të pandehurit kanë zënë në pritë veturën "Golf 2" me numër të regjistrimit, 469KS117, në të cilin, Neshat Baftiu, Urim dhe Sylejman Baftiu (së bashku me Bujar dhe Sadik Baftiun) udhëtonin në drejtim të fshatit Dubravë. Kur vetura arriti urën e Lepencit, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi (të cilët prisnin në anën e djathtë të rrugës) hapën zjarrë kundër veturës me dy pushkë automatike, AK 47. Neshat Baftiu, u qëllua nga shumë plumba në anën e djathtë të trupit dhe një plumb e qëlloi atë në pjesën e djathtë të kokës, duke depërtuar në tru dhe që i shkaktoj vdekjen. Urim Baftiu vdiq nga lëndimet e shkaktuara në zemër, mushkëri dhe mëlçi nga plumbat dhe Sylejman Baftiu vdiq si rezultat i lëndimeve të shkaktuara nga plumbat në pjesën e djathtë të kokës së tij.

**Kështu, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, së bashku kanë kryer veprë penale të vrasjes së rëndë, në kundërshtim me nenet 23, 147, paragrafin 1, nënparagrafët 3 dhe 11, të KPK-së.**

#### **b. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi**

## **SHPALLEN FAJTOR**

Sepse, në mes të 00.10-00.15, të natës në mes të 27 dhe 28 shtator 2007, ata e vranë Neshat, Urim dhe Sylejman Baftiun në mënyrë dinake në urën e Lepencit (e vendosur në autostradën, Prishtinë-Shkup e cila çon në fshatin Saponicë). Në veçanti, të pandehurit kanë zënë në pritë veturën "Golf 2" me numër të regjistrimit, 469KS117, në të cilin, Neshat Baftiu, Urim dhe Sylejman Baftiu (së bashku me Bujar dhe Sadik Baftiun) udhëtonin drejtim të fshatit Dubravë. Kur vetura arriti urën e Lepencit, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi (të cilët prisnin në anën e djathtë të rrugës) hapën zjarr kundër veturës me dy pushkë automatike, AK 47. Së paku 40 gëzhoja, të AK 47, kalibri 7, 62 ishin shtënë kundër veturës të përdorura nga viktimat. Bujar Baftiu ishte qëlluar nga plumbat në kokë dhe në anën e djathtë të barkut, duke përfshirë dhe indet e lëkurës, indet qelizore, *colon ascendens* që pastaj është shpuar dhe është përhapur në zgavrën e barkut dhe në veçanti duke dëmtuar *omentum majus*. Përkundër lëndimeve serioze të shkaktuara, Bujar Baftiu mbijetoi.

Sadik Baftiu drejtpërdrejt i ishte ekspozuar rafalëve të plumbave të cilat shkaktuan vdekjen dhe lëndimet e viktimave të tjera por mrekullisht mbeti i padëmtuar.

Duke vepruar kështu, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, me qëllim kanë ndërmarr veprim të menjëhershëm në drejtim të kryerjes se veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, **kështu që së bashku kanë kryer veprën penale të përshkruar në nenet, 20, 23, 147, paragrafin 1, nënparagrafit 3 dhe 11, të KPK-së.**

### **c. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi**

## **SHPALLEN FAJTOR**

Sepse, në rrethanat e përshkruara më lart, nën pikat 1 dhe 2, ata pa autorizim kanë transportuar, kishin në posedim dhe kanë përdorë dy pushkë automatike, të modelit AK-47, Kallashnikov, të kalibrit, 7.62, me anën e së cilave ata kanë kryer veprat penale të përshkruara më lart, nën a dhe b.

**Kështu që, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, kanë kryer vepër penale të Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2, i KPK-së.**

### **d. Avket Vishi**

## **SHPALLET FAJTOR**

Sepse, në një datë jo të specifikuar të muajit shtator 2007, ka marr nga Neshat Baftiu një pushkë automatike, AK-47, Kallashnikov, kalibri 7.62. Avket Vishi ka testuar një armë të tillë automatike në malin e Lubotenit. Pas vrasjes së Neshat Baftiut, ai kërkoj dhe siguroj nga Bl.B., vëllai i Neshat Baftiut kthimin e pushkës së përmendur AK 47, së bashku me një pushkë tjetër AK 47, të cilën e mori me vete.

**Kështu që ka kryer veprë penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2, i KPK-së.**

**Në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, i KPPK-së**

**e. Nysret Cena**

## **LIROHET**

Sepse, nuk është vërtetuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat ishte akuzuar nga Prokurori publik në Aktakuzën e ngritur më 14.09.2009, n. 41/09.

## **PRANDAJ**

### **1. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi dënohen**

- a. me dënim me burgim afatgjatë me kohëzgjatje prej tridhjetë e tri (33) vitesh sa i përket veprës penale të përshkruar në pikën **a**;
- b. me dënim prej dhjetë (10) viteve burgim sa i përket veprës penale të përshkruar në pikën **b**;
- c. me dënim prej dy (2) viteve burgim, sa i përket veprës penale të përshkruar në pikën **c**.

Në pajtim me nenin 71, paragrafi 2, nënparagrafi 1, dënimi unik prej tridhjetë e tri (33) viteve burgim afatgjatë iu shqiptohet Besnik Hasanit dhe Shpend Qerimit.

**2. Avket Vishi dënohet** gjobë prej 5.000,00 eurosh sa i përket veprës penale të përshkruar në pikën d. Gjoba do të paguhet nga i pandehuri brenda tre (3) muajsh pasi që Aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast se gjoba nuk mblidhet me detyrim, pagesa e gjobës do të zëvendësohet me një ditë burgim për çdo pesëmbëdhjetë euro të gjobës.

**Në pajtim me nenet 112,2 dhe 392, të KPPK-së, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi në mënyrë kumulative dhe së bashku**

## **DËNOHEN**

Pagesa prej 25.000 eurosh tek secila palë e dëmtuar, M.B., H.B., I. B., Buajr Baftiu, si kompensim i pjesshëm për dëme të shkaktuara morale. Gjykata me anën e kësaj udhëzon palët e dëmtuara (duke përfshirë, Sadik Baftiun, i cili nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike gjatë shqyrtimit kryesor) se ata mund të ndjekin pjesën tjetër të pasurisë juridike përmes kontestit civil, pasi që të dhënat në procedurat penale nuk ju siguron një bazë të besueshme për një çmim të plotë.

Në pajtim me nenin 102, paragrafin 1, të KPPK-së, të pandehurit do të kthejnë paratë e shpenzimeve të procedurës penale, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një

Aktivendim ndaras mbi shumë e shpenzimeve do të bëhet nga Gjykata kur të dhëna të tilla do të sigurohen, në pajtim me nenin 100, paragrafi 2, i KPPK-së.

## ARSYETIMI

### 1. Sfondi procedural – Aktakuza

Me 2 Nëntor 2009 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës deponoi në gjykatë aktakuzën numër PPS 41/09, kundër të pandehurve Besnik Hasani, Shpend Qerimi, Nysret Cena, Z. B., V. R. dhe Avket Vishi, duke i ngarkuar të pandehurit me vrasje të rëndë, tentim vrasje të rëndë (Besnik Hasani, Shpend Qerimi dhe Nysret Cena), bashkim kriminal (Avket Vishi, V. R. dhe Z. B.) dhe mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve (Besnik Hasani, Shpend Qerimi, Avket Vishi dhe V. R.).

Pas seancës mbi konfirmimin, vetëm akuzat e listuara më lart ishin konfirmuar kundër të pandehurve Hasani, Qerimi, Cena dhe Vishi.

Shqyrtimi i hapur kryesor ishte mbajtur me 16, 17, 18 Qershor 2010, 13, 14, 15 Korrik 2010, 6, 14, 16, 29 Shtator 2010, 21 Tetor 2010, 5 dhe 9 Nëntor 2010, 31 Janar 2011, 1 Shkurt 2011, në prani të Prokurorit të PSRK-së, Z. Reshat Millaku, të të gjithë të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës.

Gjatë shqyrtimit kryesor janë marrë në pyetje dëshmitarët siç vijojnë:

- M.B., H.B., Bujar Baftiu, I. B. (16 Qershor)
- S.K., R.T. (17 Qershor)
- R.M., N.A. (18 Qershor)
- A.B., N.B. (23 Qershor)
- B.B., Bl.B., V.B. (24 Qershor)
- X.T., S. V. (13 Korrik)
- Ar.B. (13 Korrik dhe 14 Korrik)
- I.D., A. K. (14 Korrik)
- F.B., B. M. (15 Korrik)
- F.N. (6 Shtator)
- D.H, M.D, K.S. (14 Shtator)
- A.A., F.V., I. M. (16 Shtator)
- R. Q., M.G. (29 Shtator)
- A. Z. (30 Shtator)
- S.B. (21 Tetor)
- B. R. (6 Shtator)

Pas prezantimit të provave materiale janë ekzaminuar të pandehurit.

Pleqërimi dhe votimi janë mbajtur me 4 Shkurt dhe 7 Shkurt 2011 dhe aktgjykimi është shpallur publikisht me 7 Shkurt 2011.

Në pajtim me Nenin 15 të KPPK-së përkthyesit ndërkombëtarë përkthyen procedurën gjyqësore dhe të gjitha dokumentet gjyqësore relevante për shqyrtimin kryesor në Shqip dhe Anglisht, siç ishte nevojta.

## 1.1. Mocionet e palëve

Gjatë shqyrtimit kryesor palët deponuan disa mocione për pranimin e provave të reja. Përveç dokumenteve tashmë ekzistuese në dosje të lëndës janë pranuar edhe provat siç vijojnë:

- Aktvendimi mbi fillimin e hetimeve në rastin, para Gjykatës Komunale të Ferizajt, kundër F. H.t dhe deklaratat e bëra nga dëshmitari R.T. gjatë asaj procedure.
- Regjistrimi i komunikimit me radio, të natës në mes 27 dhe 28 Shtator 2007, lidhur me komunikimet që janë bërë në mes 24.00 të 27 Shtatorit dhe 1.00 të 28 Shtatorit (Stacioni i Policisë Kaçanik).
- Protokollin e shërbimit të bërë gjatë natës së njëjtë nga Policia Patrulluese e Kaçanikut nr. 4 (Udhëheqës i patrullës Oficeri R.M.).
- Një listë e të gjitha aksidenteve me automjete që kanë ndodhë gjatë natës së 27-28 Shtatorit 2007 në juridiksionin e Ferizajt, me të dhëna lidhur me veturën e përfshirë në aksident dhe shoferin.
- Instituti Meteorologjik i Kosovës pajisi trupin gjykues me certifikatë të periudhës së hënës dhe kushteve meteorologjike të natës kritike.
- Listingu e thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS që lidhen me telefonat e të pandehurve Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi (nëse jo të marra në dosje të lëndës);
- CD e siguruar nga dëshmitari F.N. që përmban disa biseda në mes tij dhe R. Tushës.
- Transkripti i mesazheve SMS të shkëmbyera në mes telefonave të F.N.t dhe R. T.s në periudhën në mes 1 Tetorit 2009 dhe 30 Prillit 2010.
- Listingu i thirrjeve telefonike të bëra dhe të pranuar nga M. dhe I.D. dhe A.A. në periudhën 25-29 Shtator 2007;
- Mesazhet SMS të pranuar nga dëshmitari F.V. në periudhën e caktuar në urdhër.
- Raporti policor që i ka bërë i pandehuri Besnik Hasani eprorëve të tij mbi faktet të cilat ishin duke u hetuar;
- Tri harta të bëra nga ajri me shkallë metrike të bashkëngjitur që përkrahte ekzaminimin e Besnik Hasanit;
- Një hartë skicë (gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit R. M.).

Trupi gjykues kërkoi ex-officio nga Pro-Credit që të pajis Gjykatën me informata lidhur me xhirollogarinë bankare të Besnik Hasanit, në veçanti lidhur me informatat siç vijojnë:

- shuma e parave që Besnik Hasani ka pasur në xhirollogarinë bankare gjatë kohore 20 deri 30 Shtator 2007
- shuma ditore e parave që Besnik Hasani e kishte të lejuar të tërheq nga xhirollogaria bankare në ATM automat.

Dëshmitarët A. Z., K. I. dhe A. Y. ishin pranuar pas kërkesës së bërë nga palët. Nga pamundësia për të thirrur në mënyrë të rregullt A. Y. deklaratat e saja të mëparshme janë lexuar për procesverbal të shqyrtimit kryesor.

Mocionet tjera të palëve janë refuzuar nga trupi gjykues.

Trupi gjykues këtu në tërësi konfirmon aktvendimet e arsyetuara të lëshuara gjatë shqyrtimit kryesor për të refuzuar propozimet e palëve për të marrë prova, për arsyet e njëjta të cekura aty.

Në veçanti:

- Ekzaminimi si dëshmitar i F.V.t dhe F. T..
- Ballafaqimi në mes dëshmitarëve R.T. dhe F.N., Ar.B. dhe A.B. nuk ishte pranuar, duke marrë parasysh që mospërputhjet e vogla në mes deklaratave përkatëse ishin sqaruar mjaft, po ashtu nga pikëpamja e strukturës së provave tjera.
- Dëshmitarët tjerë të propozuar nga mbrojtja gjatë seancës së njëjtë (M. S. dhe R. H.) nuk janë pranuar sepse janë quajtur si jo relevant për vendimin.
- Mocioni i mbrojtjes për të marrë sqarime nga KEK-u lidhur me atë nëse ka pasur ndërprerje të rrymës me 27-28 Shtator 2008 është menduar të jetë e panevojshme duke marrë parasysh provat tashmë të paraqitura.
- Ekzaminimi si dëshmitarë i M. J., Y. M. dhe N. I. nuk është pranuar sepse ishte e panevojshme, duke marrë parasysh provat e lëndës tashmë të pranuar, apo jo relevante.

Duhet të përsëritet këtu që kërkesa për rikonstruksion të vendit të krimit nuk mund të ekzekutohet me sukses gjatë shqyrtimit kryesor pasi ishte e pamundur të riprodhohen kushtet e njëjta meteorologjike dhe ndriçuese të natës kritike.

Në anën tjetër inspektimi i vendit të krimit është vërtetuar të jetë i panevojshëm, duke konsideruar sasinë gjigante të dokumenteve provë të paraqitura në dosje të lëndës (fotografi, fotografi nga ajri, harta skicë), të cilat i janë parashtruar dëshmitarëve gjatë ekzaminimit të tyre dhe prandaj ishte tepër e mjaftueshme për të zbardhur çështjet faktike dhe topografike të lidhura me rastin.

## **2. Kompetenca e Gjykatës**

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 i KPPK-së, gjykatat e qarkut kanë juridiksion të gjykojnë në shkallë të parë vepra penale të dënueshme me burgim me më së paku pesë vjet ose me burgim afatgjatë.

Vrasja e rëndë dhe vrasja e rëndë në tentativë të shënuara në aktakuzë të dy dënohen me burgim afatgjatë, prandaj kompetenca materiale bie mbi gjykatën e qarkut.

Sipas aktakuzës, vepra penale ka ndodhur në rrugën që qon tek fshati Dubravë, Komuna e Kaçanikut. Kështu që në pajtim me nenin 27 par. 1 të KPPK-së, gjykata e qarkut në Prishtinë ka kompetencë territoriale për të gjykuar këtë rast.

Në pajtim me nenin 3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Rasteve dhe Caktimin e Rasteve Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it (më tutje LoJ), Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar për një procedurë penale do të kenë juridiksion dhe kompetenca mbi çdo rast të hetuar apo të ndjekur penalisht nga PSRK.

Lënda aktuale është hetuar dhe akuzuar nga Prokurori i PSRK-së; prandaj, në pajtim me nenin 4.7 të LoJ, trupi gjykues i gjykatës së qarkut ishte përbërë nga trup i përzier i dy gjykatësve të EULEX-it dhe një gjykatësi vendor.

Asnjë nga palët nuk e ka kundërshtuar përbërjen e trupit gjykues.

## **3. Gjetjet faktike dhe juridike**

Lista e mëposhtme e fakteve, ose e pa kontestuar ose bazuar në provat e nënvizuara siguron historikun e ngjarjeve që janë objekt i procesit.

- a. Në natën në mes 27 dhe 28 Shtator 2007, në mesnatë, Neshat, Urim, Sulejman, Bujar dhe Sadik Baftiu janë larguar nga Restorant Mani (gjendet në magjistralen Ferizaj-Kaqanik) në drejtim të fshatit të tyre Dubravë, disa kilometra në jug<sup>1</sup>. Ata ishin duke udhëtuar në një Golf II të kuq të Neshat Baftiut.
- b. Pas arritjes tek Varrezat e Dëshmorëve, që gjenden në magjistrale nja dy kilometra në jug të Restorantit Mani<sup>2</sup>, ata morën kthesën në të majtë që qon tek fshati Dubravë. Magjistralla deri tek varrezat dhe rruga nga varrezat që qon tek Dubrava kalon në mes fushave dhe pyjeve të izoluar, me disa ndërtesa të shpërndara.
- c. Rreth një kilometër e gjysmë pas udhëkryqit<sup>3</sup>, duke kaluar urën mbi lumin Lepenc (më tutje: “Ura e Lepencit”), vetura ishte zënë në pritë. Një breshëri plumbash të pushkës automatike të tipit AK 47 janë shtënë në veturë dhe në udhëtarë të veturës nga ana e djathtë e rrugës<sup>4</sup>. Dy armë automatike kanë shtënë në të njëjtën kohë, sipas kujtesës së Bujar Baftiut dhe sipas ekspertizës balistike të bashkëngjitur dosjes së lëndës.
- d. Gjuajtja me armë ka ndodhur rreth 00.10 me 28.9.2007<sup>5</sup>.

<sup>1</sup> Shiko deklaratat e dëshmitarëve Bujar dhe Sadik Baftiu

<sup>2</sup> Shiko hartat fotografike #1 dhe 2, të pranuar *ex-officio* dhe të bashkëngjitura dosjes së lëndës, me numra që u treguan nga Besnik Hasani gjatë seancës së 5.11.2010. Asnjë palë nuk e kontestoi saktësinë e hartave të përmendura dhe shkallës metrike të paraqitur aty. Ekzaminimi i të dy hartave dhe shkallës së distancës të përfshirë në harta tregon që distanca në mes Restorant Mani dhe udhëkryqit të Varrezave të Dëshmorëve (“Varrezat e Dëshmorëve”) është rreth 2.400 metra.

<sup>3</sup> Një vlerësim i përafërt i tillë buron nga dëshmitari R.T. dhe nga deklarata e dëshmitarit R. M., procesverbal i shqyrtimit të datës 18.6.2010 faqe 16. Ekzaminimi i hartës, hartat #1, të marra *ex officio* dhe të bashkëngjitura dosjes së lëndës, me numra të treguara nga Besnik Hasani gjatë seancës së 5.11.2010, siguron konfirmim dokumentar që distanca rrugore në mes varrezave dhe vendit të ngjarjes (të treguara nga Besnik Hasani me numër 7) në hartë është rreth një kilometër.

<sup>4</sup> Shiko deklaratat e dëshmitarëve Bujar dhe Sadik Baftiu, së bashku me kallëzimin penal, me vlerësimet forenzike, të datës 28.9.2007, dhe të nënshkruara nga oficeri i policisë A. M. (dosja 3 e dosjes së lëndës) që përmban vizatimet dhe skicat, dokumentet fotografike të incidentit dhe raportin balistik mbi natyrën e fishekëve të shumtë të kalibrit-7,62/39 të shtënë dhe të gjetur në vendin e ngjarjes në anën e djathtë të rrugës.

<sup>5</sup> Disa dëshmi të mbledhura gjatë shqyrtimit kryesor kanë dërguar tek ky përfundim. Dëshmitë e tilla janë krejtësisht të qëndrueshme, pa kontradikta apo mospërputhje. Trupi gjykues nuk gjen ndonjë arsye për të përjashtuar ndonjë nga to. Dëshmitë janë siç vijojnë:

- **Bujar Baftiu** në dëshminë e tij me 21 Qershor 2010, ku ai shpjegon që gjuajtja ka ndodhur rreth orës 00:12, nga dy qitës dhe nga një distancë rreth 1,5 deri 2 metra në mes tyre.
- **N.B.** deklaroi se ai u largua nga Kaqaniku i Vjetër rreth mesnatës dhe kur ai ka dëgjuar armët e zjarrit ai tashmë kishte udhëtuar rreth dhjetë minuta. Ai ka arritur tek ura vetëm disa minuta pas dëgjimit të të shtënave (të cilat në fillim i ngatërroi me gomë të shfryrë). Kjo lejon të përcaktohet koha e gjuajtjes - sipas versioni të N.B.t, dhe në vijë me rikonstrukcionin e lartpërmendur – rreth orës 00.10 apo disa minuta më vonë Bujar Baftiu ka konfirmuar se vetura e Neshatit ka kaluar pranë një periudhë kohore shumë të shkurtër pas gjuajtjes me armë.
- **S.K.** (oficeri i parë i policisë të arrij në vendin e ngjarjes) ka arritur tek ura rreth orës 00:20 dhe e ka parë veturën dhe njerëzit e lënduar, dhe ka kërkuar ndihmë. Në “rreth 00:15”, R.M. ka pranuar përmes Radios kërkesën për ndihmë nga vendi i ngjarjes, dhe rreth dhjetë minuta më vonë (00:30) ai ka qenë në vendin e ngjarjes. Kjo kujtesë e shprehur me një shkallë të caktuar të paqartësisë për shkak të kohës së kaluar, është në pajtim me raportet policore të pranuar nga Stacioni i Policisë së

- e. Si pasojë e gjuajtjes me armë vetura godet rrethojën mbrojtëse të djathtë në mes të urës, duke u ndaluar aty<sup>6</sup>.
- f. Neshat Baftiu, Sulejman Baftiu dhe Urim Baftiu vdesin si pasojë e gjuajtjes me armë<sup>7</sup>; Bujar Baftiu ishte lënduar rëndë<sup>8</sup> dhe Sadik Baftiu shpëton e pa lënduar.
- g. Personi i parë që ka kaluar pranë vendit të ngjarjes pas gjuajtjes me armë ka qenë N.B., i afërm i Bujar Baftiut, i cili rastësisht ka udhëtuar në veturën e tij në urë vetëm disa minuta pas ngjarjes. Ai ka parë pozicionimin e veturës së viktimave në urë dhe nuk është ndaluar, duke mos ditur se çka ishte duke ndodhur. Bujar Baftiu ka qenë në gjendje, me gjithë plagët e tij, ta vërej atë dhe të i telefonoj atij në mënyrë që të kërkoj nga ai të kthehet tek vendi i ngjarjes, ku ai kthehet 5-7 minuta më vonë, së bashku me të tjerët.
- h. Para se të arrij ai, një patrullë policie e udhëhequr nga Oficeri i Policisë S.K. në ndërkohë kishte arritur tek vendi i ngjarjes<sup>9</sup>. Zona ishte siguruar dhe viktimat ishin transportuar nga aty.

Ferizajt (që vërteton se në ora 00:20 një thirrje anonime ka informuar Lima Kontroll lidhur me gjuajtjen me armë).

- **Sadik Baftiu** ka dëshmuar se ai (së bashku me viktimat tjera) janë larguar nga restorant Mani rreth mesnatës apo 00:05. Duke marrë parasysh distancën në mes restorantit dhe vendit të ngjarjes (rreth 3,4 kilometra) mund të mendohet se me një shpejtësi normale (p.sh. rreth 60/70 km në orë në magjistrale dhe rreth 30/40 në orë në rrugë me kthesa pas udhëkryqit tek varrezat e Dëshmorëve) nuk do merrte më shumë se 5 minuta nga restoranti deri tek vendi i ngjarjes. Sadik Baftiu në deklaratën e tij para Prokurorit Publik me 2 Mars 2009 ka përmendur se nja dy minuta pas të shtënave ka kaluar N. dhe pas dy minutave tjerë (përafërsisht) ka arritur Policia. Nga të gjitha ne mund të përfundojmë, sipas dëshmisë së tij, se koha e gjuajtjes me armë mund të individualizohet rreth **00:10**.
- **F.B.** ka deklaruar se ka thirrur Nehatin përafërsisht rreth 00:20 por askush nuk është përgjigjur, kështu që është e besueshme se në atë kohë gjuajtja me armë tashmë kishte ndodhur.
- **Raporti i Policisë** i bashkëngjitur me raportin e autopsisë së Neshat Baftiut vërteton se trupi ishte gjetur në ora 00:20, që vërteton konkludimin se gjuajtja me armë ka ndodhur rreth 00:10 pasi dëshmitari okular Bujar Baftiu dëshmoi se kanë kaluar disa minuta derisa ka arritur patrulla e parë e Policisë në vendin e ngjarjes (S.K.).

Në strukturën e përmendur lart, elementet provuese lejojnë të konkludohet se koha më e mundshme e kryerjes së krimit është rreth 00:10.

<sup>6</sup> Prapë shiko dokumentet fotografike të raportit policor të datës 28.9.2007, dhe po ashtu deklaratat e oficerëve të policisë që intervenuan në vendin e ngjarjes menjëherë pas incidentit.

<sup>7</sup> Rrethana është e pa kontestuar dhe pavarësisht qartë është konstatuar në raportin e autopsisë të bashkëngjitur dosjes 3 të dosjes së lëndës, të datës 28/9/2007 (sa i përket Neshat dhe Urim Baftiut) dhe 9/10/2007 (sa i përket Sulejman Baftiut). Në veçanti vdekja e Neshat Baftiut ishte shkaktuar nga një plumb që kishte goditur kafkën; vdekja e Urim Baftiut ishte shkaktuar nga plumbi i cili kishte depërtuar brenda organeve të brendshëm (shpretkë, mushkëri dhe palcën e kurrizit); Vdekja e Sulejman Baftiut ishte shkaktuar nga një predhë që kishte goditur kokën, mbi vesh.

<sup>8</sup> Shiko deklaratat e Bujar Baftiut gjatë seancës së 16.6.2010 së bashku me raportet mjekësore të përfshira në dosje të lëndës. Bujar Baftiu deklaroi siç vijon: *"Jam qëlluar nga disa plumba, tre në kokë, 7-8 në anën e djathtë të barkut dhe 3 në shpatullën e majtë. Jam pranuar në spital 12-13 ditë. Një ditë pasi ka vdekur Sulejmani kam qenë i mërzhitur dhe nuk kam mundur të qëndroj në spital. Kam kërkuar nga mjeku të më liroj dhe të vazhdoj tretmanin në shtëpi. Tretmani ka vazhduar për 3-4 muaj"*.

<sup>9</sup> Deklaratat e N.B.t, procesverbal i shqyrtimit kryesor i datës 23.6.2010, faqe 33. Deklaratat e S.K.t, procesverbal i shqyrtimit kryesor të 17 Qershorit 2010, sipas së cilës patrulla e policisë duke udhëtuar përgjatë rrugës së Urës së Lepencit "rreth 12.20" ka hasur në Golfën II të kuq të viktimave të ndaluar në anën e majtë, me pesë udhëtarë brenda. Askush nuk ka qenë aty derisa ka ardhur, është kthyer N.B. aty. Kjo do të thotë që kur patrulla e policisë ka arritur tek vendi i ngjarjes, N.B. tashmë kishte qenë aty dhe se kishte vazhduar përgjatë rrugës tashmë vetëm për tu kthyer "5-7 minuta" më vonë.

- i. Rreth orës 12.20 patrulla e policisë e komanduar nga Oficeri R. M., e cila në atë kohë ishte duke patrulluar në fshatin Vataj, dëgjoji një radio mesazh të shërbimit që kërkonte ndihmë tek Ura e Lepencit ku ishte kryer një vrasje. Prandaj patrulla e policisë filloi të shkoi në drejtim të vendit të ngjarjes. Përafërsisht një minutë pas thirrjes në radio<sup>10</sup> ata kanë hasur në një veturë VW Golf që vinte nga drejtimi i lagjes së Dalloshëve<sup>11</sup>. Zënia në rrugë ka ndodhur në udhëkryqin me Rugën e Soponicës. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi kanë qenë brenda veturës së tillë. Oficerët e policisë ndaluan veturën dhe menjëherë pasi kuptuan se vozitës ishte një oficer i policisë ata e lejuan të shkoi<sup>12</sup>.
- j. Disa ditë pas ngjarjes, janë shpërndarë thashetheme në fshat se dy persona, R.T. dhe X.T., kanë qenë dëshmitarë të krimit. Kështu që familjet e viktimave kontaktojnë me ta në mënyrë që të marrin informata lidhur me ngjarjet<sup>13</sup>.

Hetimi fillimisht ishte udhëhequr nga SHPK në Ferizaj por disa javë më vonë ishte marrë në dorëzim nga policia e UNMIK-ut.

Dëshmitarët e ekzaminuar gjatë hetimeve i kanë siguruar prokurorit elemente të fajësisë kundër Avket Vishit për sa i përket veprës penale jo direkt të lidhur me vrasjen në urën e Lepencit.

Në pjesën e arsyetimit që vijon do të ekzaminohen provat specifike për secilin të pandehur dhe rolin e tyre në vrasje.

### 3.1. Shpend Qerimi dhe Besnik Hasani

Konstrukt i provave kundër Shpend Qerimit dhe Besnik Hasanit është i trefishtë.

E para, bazohet në deklaratat e dëshmitarit R.T. i cili përfundimisht ka identifikuar të pandehurin Shpend Qerimi në vendin e ngjarjes fill para vrasjeve

E dyta, një numër i dëshmitarëve konfirmojnë se R.T. u ka thënë atyre se një burrë, më pas i njohur si Shpend Qerimi, ka qenë në vend të ngjarjes natën e vrasjes.

E treta, janë marrë prova të fuqishme rrethanore që qartas puqen në drejtim të të pandehurve, duke treguar nga ta si persona që natën kritike kanë qenë në vend të ngjarjes, të armatosur me pushkë automatike, fill para se të ndodhë gjuajtja me armë.

---

Analiza e përbashkët e dëshmimeve të S.K.t dhe e N.B.t, më herët e përmbledhur, tregon se të dy versionet në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra pajtohen sa i përket kronologjisë së gjuajtjes me armë.

<sup>10</sup> Minutazha është lehtë të merret, nga deklarata e R. M. para trupit gjykues, kur ai thotë se menjëherë pas marrjes së thirrjes në radio ai fillon të vozis shpejt (rreth 80 km/h) në drejtim të vendit të ngjarjes dhe se vendi ku ai ka hasur në Besnik Hasanin ka qenë në një distancë prej vetëm një kilometër nga vendi ku kishte marrë radio thirrjen. Mund të konkludohet se për të kaluar një kilometër me shpejtësi 80 km/h nuk nevojitet më shumë se një minutë. Minutazha e ndryshme të supozuar nga dëshmitari (rreth 10 minuta) konsiderohet nga dëshmitari vet si jo e saktë: trupi gjykues, megjithatë, mendon se rikonstruktimi në bazë të distancës së hapësirës dhe të shpejtësisë së veturës është më e besueshme, duke u bazuar në fakte të cilat nuk mund të kontestohen (p.sh. vendi ku ishte vetura e policisë në kohën kur niset në drejtim të vendit të ngjarjes, dhe vendi ku është takuar me veturën e Besnik Hasanit).

<sup>11</sup> Lagjja e Dalloshëve është shënuar me numër 5 në hartën #1 të pranuar ex officio. Shenja është bërë pasi është treguar nga Besnik Hasani gjatë ekzaminimit të tij. Siç mund të konstatohet lagjja e Dalloshëve gjendet përgjatë rrugës që vjen nga vendi i ngjarjes në drejtim të vendit ku policia ka hasur në veturën e Besnik Hasanit, në një distancë prej rreth një kilometër nga vendi i tillë.

<sup>12</sup> Rrethana thjeshtë pranohet nga të pandehurit.

<sup>13</sup> Lidhur me këtë shiko deklaratat e R. T. dhe gati të gjithë dëshmitarët e familjes Baftiu të cilët ishin thirrur në gjykim.

Paraprakisht duhet të konstatohet se disa rrethana faktike janë ose të pa kontestuara nga mbrojtja ose ngritën thjesht nga administrimi i provave.

I bëhet referencë rrethanave të kohës dhe vendit të ngjarjes, siç përshkruhet dhe arsyetohet më lartë nën shkronjat “a” deri te “j”.

### 3.1.1. Deklaratat e R. T.

R.T. i ka dhënë (së pari para hetuesve dhe më pas Gjykatës) katër rrëfime të ngjarjes së 27/09/2007. Ato sigurojnë të njëjtin përshkrim të ngjarjeve, por ndryshojnë sepse në ekzaminimin e parë dhe të fundit R.T. ka deklaruar se nuk ka qenë në gjendje të njoh Shpend Qerimin si personin që ka qenë në urë

Gjatë ekzaminimit në shqyrtim kryesor ai fuqishëm është ballafaquar me deklaratat e mëparshme (ajo e 20.11.2007 dhe e 21.2.2008 dhe ajo e Marsit 2009 para Prokurorit Publik).

Para trupit gjykues (në seancën e 17.6.2010) ai ka deklaruar, si përmbledhje, siç vijon:

- Natën e 27/9/2007 ka qenë në Kaqanik së bashku me shokun e tij X.T.. Rreth orës 11.30 në mbrëmje ai është larguar me taksi në drejtim të shtëpisë së tij. Ai ka dalë nga taksi kur ka arritur tek Varrezat e Dëshmorëve, që gjenden në magjistralen Ferizaj-Kaqanik. Nga aty ka filluar rruga në drejtim të fshatit Dubravë<sup>14</sup>.
- Ai dhe X.T. kanë filluar të ecin gjatë asaj rruge në drejtim të shtëpisë së tij, që gjendet tek lagja Tusha në fshatin Soponicë. Për të arritur tek shtëpia e tij atij i nevojitet të kaloj Urën e Lepencit.
- Përafërsisht 200 metra para se të arrijnë urën, duke ecur para shkollës Provaliu, ata janë parakaluar nga një veturë Audi, model i ri A4 ose A6, që shkonte në drejtim të urës së Lepencit. Ngjyra e veturës ishte e hirit metalike dhe nuk ka ngadalësuar gjatë parakalimit të tyre<sup>15</sup>. R.T. nuk njohu asnjë nga udhëtarët në veturë deri sa ishin duke u parakaluar, pavarësisht asaj se ishin në gjendje të vërenin ata brenda veturës.
- Dukshmëria gjatë asaj nate ishte e mirë dhe ishte hëna e plotë. Audi i hirtë u ndalua përafërsisht njëqind metra pas parakalimit të dëshmitarit, fill para urës së Lepencit. Dy persona dolën nga vetura dhe qëndruan në vend, pak metra para urës, ndërsa Audi vazhdoi përtej urës, në drejtim të fshatit Nikaj.
- R.T. dhe X.T. vazhduan duke ecur në drejtim të urës, pavarësisht nga frika e shkaktuar nga prania e dy personave pranë urës: frikë që nxiti R. T. të pyes X. T. nëse ishte dashur të armatosen me gurë<sup>16</sup>. Në fund T. u kufizuan vetëm të kalojnë

<sup>14</sup> Të gjitha vendet relevante mund të shihen lehtë në hartat ##1 dhe 2 të bashkëngjitura dosjes së lëndës, të marra ex officio me rastin e ekzaminimit të Besnik Hasanit.

<sup>15</sup> R.T.: taksi na la tek Varrezat e Dëshmorëve dhe ne vazhduam tek shtëpitë tona. Arritëm tek Shkolla Provaliu dhe në atë kohë kaloi vetura.

Prokurori Publik: A mund ta përshkruash veturën?

R.T.: Ishte një Audi. Nuk kam parë ndonjë imtësi të veturës pasi ishte errësirë.

Prokurori Publik: A ju kujtohet çfarë keni deklaruar gjatë hetimit lidhur me tipin e veturës?

R.T.: Unë nuk i njohe veturat aq mirë, mendoj A4, 6, nuk i njoh.

Prokurori Publik: A u ndalua vetura kur ju afrua juve?

R.T.: Vetura u ndal para se të shkoj tek ura.

Prokurori Publik: Derisa ishit duke ecur afër shkollës, a e ngadalësoi vetura apo e shpejtoi?

R.T.: Ishte duke vozitur me shpejtësi normale.

<sup>16</sup> R.T.: Vetura na kaloi dhe u ndalua pranë urës. 2 njerëz dolën nga Audi, derisa ishte pranë urës e rriti shpejtësinë dhe ne nuk mund ta shihnim më. Shkoi në drejtim të fshatit Nikaj dhe ne nuk mund ta shihnim

rrugën në drejtim të anës së majtë, në mënyrë që të distancohen nga dy personat që ishin duke qëndruar në anën e djathtë të rrugës. Pastaj ata vazhduan ecjen e tyre duke arritur tek ura dhe duke kaluar pranë dy personave. Njëri nga ta ishte në një distancë rreth 5-6 metra nga ata, pranë një grumbulli të vogël të rërës që gjendej në anën e rrugës, dhe mbante në duar diçka sikur “*armë ose dru*”, derisa tjetri ishte duke qëndruar pranë një gardhi të drurit që gjendej disa metra më larg, në drejtim të fushës, në një distancë prej “*5-10 metra*” nga R.T..

- Burri që bartte “*armën apo drurin*” kishte të veshur një xhakëtë të zezë, ishte biond me flokë të shkurtër. R.T. ka deklaruar para trupit gjykues se nuk e dinte kush ishte ky burrë dhe se errësira e vendit e bënte të pamundur “*të njoh personat nga distanca*”.
- Pasi R.T. kalon urën, ai vazhdon deri në shtëpi. Duke hyrë në shtëpi, disa minuta më vonë, ai ka dëgjuar të shtëna të armës nga drejtimi i urës.

Siç parashikohet, ky më lartë është versioni që R.T. ka dhënë në shqyrtim kryesor.

Duke marrë parasysh mospërputhjet e nënvizuara më poshtë me deklaratat e mëparshme (të bëra para policisë me 20.11.2007 dhe me 21.2.2008 dhe para prokurorit publik me 4.3.2009), ai është ballafaquar rreth tyre nga palët dhe nga trupi gjykues.

Me të vërtetë para policisë me 20.11.2007 ai ka deklaruar:

- se vetëm një udhëtar (dhe jo dy, siç është konfirmuar me këmbëngulje më pas, po ashtu në shqyrtim kryesor) është lënë nga vetura në vend të ngjarjes;
- se kur Audi kishte kaluar urën nuk ka qenë e mundur për R. T. të shoh nëse është kthyer majtas apo nëse vazhdoi të ec drejt;
- se sendi të cilin personi e mbante në duar ishte një armë automatike e ngjashme me atë që përdorë KFOR-i;
- se ai ka parë personin në urë vetëm nga pas dhe nuk e ka parë fytyrën e tij dhe se nëse do ta shihte atë prapë ai nuk do të ishte në gjendje ta njoh atë.

Versioni i dhënë në ekzaminimi e parë policor (në të cilin ai thjesht thotë se burri në urë ishte biond dhe me flokë të shkurtër dhe se nuk ishte e mundur ta njoh), ishte zgjeruar me më shumë detaje në deklaratat e më pastajme. Disa nga plotësimet kotradiktojnë deklaratat e mëparshme.

Në veçanti, R.T. ka shtuar rrethanat siç vijojnë (të gjitha janë bërë objekt i konfrontimit gjatë shqyrtimit kryesor):

- në Janar 2008 në pompën e benzinës Ballkan Petroll në Ferizaj ai e ka parë prapë personin biond të cilin e kishte parë në vend të ngjarjes me 27.9.2007.
- natën kritike, pasi që është parakaluar nga Audi, ai ka qenë në gjendje të sheh në fytyrë pasagjerin të ulur pranë shoferit të Audit.
- Vetura e tillë ka qenë e llojit të njëjtë të asaj të ngarë nga Nysret Cena dhe ai person me flokët e ndara në mes ishte duke ngarë atë natën e vrasjes;
- Në mbrëmjen e 27/9/2007 ishte e mundur të shihet personi nga shumë larg, duke pasur parasysh dritën e hënës të ndritshme të asaj nate;
- Personi që qëndronte tek ura në anë të rrugës ishte biond dhe i veshur me xhakëtë të zezë.

---

*më. Ne vazhduam rrugën dhe shkuam në drejtim të këtyre njerëzve që dolën nga vetura. I thashë X., komshi, “t’i marrim ca gurë apo ndonjë copë druri pasi mund të na sulmojnë”. Ai më tha ata s’kanë punë me ne. Ne kaluam pranë këtyre 2 njerëzve. Shkuam në shtëpi. Kishte disi si të shtëna. Pastaj ne shkuan të flemë dhe ditën në vijim ne kuptuam që disa njerëz janë vrarë.*

Me më rëndësi, gjatë hetimit, R.T. (edhe gjatë dhënies së deklaratave në polici në Shkurt 2008 edhe gjatë ekzaminimit para prokurorit publik) ka shtuar një rrethanë të një domethënie të veçantë: ai deklaroi se rreth *“ashtu një muaj”* pas vrasjes, kur ishte tek City Bar në Ferizaj (i njohur më herët si Hotel Luboteni) në shoqëri të B.B. ai ka prapë ka parë personin i cili ka qenë në urë dhe për këtë e ka informuar B.B.n.

R.T. me atë rast ishte informuar se emri i këtij personi është Shpend Qerimi. Duke u bazuar në këtë identifikim ai deklaroi më pas tek Prokurori se ai ishte *“500% i sigurt se natën e vrasjes së Neshatit, Shpendi (Qerimi) ka qenë në urë me një armë të gjatë”*.

Relevanca e një identifikimi të tillë ishte evidente për të gjitha palët në shqyrtim kryesor<sup>17</sup>.

Nuk është për tu habitur; prandaj, që tërheqja mbrapsht radikale e R. T. në këtë çështje specifike gjatë shqyrtimit kryesor është përcjellë me konfrontime intensive nga palët lidhur me atë se cili ishte versioni i vërtetë dhe se ku ishte arsyeja për një ndryshim të papritur të deklaratës.

Duke u ballafaquar me këto mospërputhje, R.T. i ka shpjeguar trupit gjykues:

- Se nuk ishte e vërtetë që pasi ka parë Shpend Qerimin në bar në Ferizaj ai e ka njohur atë si burri nga ura e Lepencit;
- Se, përkundrazi, *“Dubravët”* (anëtarët e familjes Baftiu)<sup>18</sup> i kanë bërë presion që të deklaroj në mënyrë të rreme para policisë se burri që ata ia tregonin atij në bar të Ferizajt (Shpend Qerimi) ishte burri i njëjtë që ai kishte parë në urë dhe se Audi i cili u ndalua në urë natën e vrasjes ishte vetura e Nysret Cenës.
- Se deri në këtë masë, fillimisht R.T., vonë në mbrëmje tre ditë pas vrasjes, ishte dërguar nga A.B. në veturë tek vende të ndryshme në mënyrë që të provonin të gjenin Audin e natës kritike. Ata pretendohet se i urdhëruan atij të thotë se Audi i natës kritike ishte i ngjashëm me atë të Nysret Cenës. Për t’iu kërcënuar atij ata pretendohet të kenë marrë atë tek një autolarje, ku është lënë jashtë për një orë derisa Baftiu ishte duke folur brenda. Në pyetjen nëse ka pasur kërcënime më të këqija nga Baftiu të drejtuara atij në këtë rast, ai është përgjigjur: *“Nuk e di ndoshta ai do të më vriste apo do të më rrihte rëndë, nuk e di se çka do të më kishte bërë”*.
- Se me një rast tjetër R.T. ishte dërguar tek B.B. te një kafene në Ferizaj, ku ka qenë Shpend Qerimi i pranishëm po ashtu, së bashku me një fëmijë. Në atë rast, B.B. i ka urdhëruar atij që kur të merret në pyetje nga hetuesit, ai duhet të thotë se Shpend Qerimi ishte burri që ka qenë në urë natën kritike<sup>19</sup>. Vetëm në atë rast

<sup>17</sup> Në të njëjtën kohë, është e qartë se kjo rrethanë specifike nuk ka mundur të i referohet policisë me rastin e ekzaminimit të parë, sepse ekzaminimi është bërë në Nëntor 2007, para mbajtjes së takimit në bar të Ferizajt (Dhjetor).

<sup>18</sup> R.T.: *Çdo gjë që kam deklaruar atëherë ka qenë nën presion të kërcënimit* (faqe 13 e procesverbalit të 17.6.2010).

<sup>19</sup> Prokurori Publik: *A mund të lexoj deklaratën e dëshmitarit të dhënë para Prokurorit Publik me 4 Mars? Ti ke thënë se personi i cili bartte armën, emrin e të cilit e kam mësuar më vonë se ishte Shpend kishte flokë blond. Prapa kokës i kishte të prera shumë shkurt. Në pjesën e epërme të trupit kishte të veshur diçka të zezë me një prerje prapa sikur xhaketë burri, e saktë?*

R.T.: *Unë kam thënë lidhur me Shpend Qerimin se e njoha pas asaj nate në bar por unë nuk e di se kush ishte duke qëndruar në urë.*

Kryetari i Trupit Gjykues: *A është e vërtetë se e ke parë personin në urë?*

R.T.: *E di se kishte të veshur xhaketë të zezë.*

Kryetari i Trupit Gjykues: *Çka i ke thënë Prokurorit Publik nuk është e saktë?*

R.T. e ka mësuar emrin "Shpend Qerimi", R.T. ka deklaruar se ishte kërcënuar nga Berati, por (i pyetur veçanërisht lidhur me natyrën e kërcënimeve) ai ka thënë se në të vërtetë B.B. nuk ka bërë kërcënime specifike; ai thjesht i ka urdhëruar atij që të u deklaroj ashtu hetuesve;

- Nuk janë raportuar forma tjera të kërcënimeve nga R.T. që të jenë bërë nga Baftiut.

### 3.1.1.1. Qëndrimi i mbrojtjes për deklaratat e R. T.

Avokatët mbrojtës nënvizuan disa aspekte të cilat dyshohet se e kanë shtyrë që identifikimi i R. T. të bëjë dyshues Shpend Qerimin.

1. Së pari, gjatë seancës kryesore R.T. është tërhequr mbrapa me qëllim nga identifikimi i tij paraprak.
2. Së dyti, R.T. ha dhënë arsye për këtë kthim mbrapa. Ai ka deklaruar se është shtyrë nga Baftiu që në mënyrë të rrejshme ta identifikoj Shpend Qerimin si personin që ishte te ura në natën kritike.
3. Së treti, në rastin e marrjes në pyetje për herë të parë të R. T., d.m.th. marrja në pyetje nga policia më datën 20.11.2007, ai ka thënë se nuk e ka parë fytyrën e atij personi te ura dhe kështu nuk do të ketë mundësi ta identifikoj atë.
4. E katërta, kushtet e dukshmërisë në natën kritike nuk lejonte identifikimin e personit: kjo do të jepte dyshim të arsyeshëm në lidhje me saktësinë kohore të identifikimit të Shpend Qerimit si burri në urën e Lepencit.

Mbi të gjitha, duhet të merren parasysh disa elemente shtesë kur të vlerësohet deklaratat e R. T..

- fakti se ka zhvillime gjatë gjithë deklaratave të R. T. si edhe me identifikimin e Shpend Qerimit si burri te ura (me kthimin mbrapa para trupit gjykues).
- Fakti se disa anëtarë të familjes Baftiu, të cilët në gjykim kërkuan kompensim nga të pandehurit, disa herën kanë kontaktuar R. T. me qëllim të marrjes së informatave në lidhje me personat që janë parë te ura shumë pak para vrasjes.

E fundit dhe më e rëndësishmja i pandehuri Besnik Hasani dhe avokati mbrojtës i Shpend Qerimit kanë dhënë një alibi mbrojtës duke supozuar se në kohën e vrasjes Hasani dhe Qerimi ishin te D. në fqinjësi, ku Besnik Hasani kishte një takim me I.D.n. Kjo alibi gjithashtu do të jepte sqarim të mjaftueshëm në faktin se Besnik Hasani dhe Shpend

---

*R.T.: Është e vërtetë atë se çka i kam treguar, por më kanë thënë të i them ashtu.*

*Kryetari i Trupit Gjykues: Ke deklaruar para Prokurorit Publik se e ke parë një burrë biond me flokë të shkurtër?*

*R.T.: Po.*

*Kryetari i Trupit Gjykues: Tani neve na deklaroje se nuk e ke parë atë?*

*R.T.: Kam parë dikë me flokë biond, ai ka pasur xhaketë të zezë të veshur por nuk e di se kush ishte ai burrë. Berat më pruri tek kjo kafene dhe më tha se ishte Shpend Qerimi.*

*Kryetari i Trupit Gjykues: A i kishte flokët e shkurtat?*

*R.T.: Po.*

*Kryetari i Trupit Gjykues: Pastaj ke thënë se ishte Shpend Qerimi pasi Berati të ka thënë të thuash kështu?*

*R.T.: Po, natyrisht pasi unë nuk e kam njohur atë më përpara.*

*Prokurori Publik: A të ka thënë Berati të thuash se ai kishte flokë bionde të shkurtër?*

*R.T.: Berati më ka thënë se ky ishte burri që ka qenë pranë urës. Ky është Shpend Qerimi burri që ka qenë tek ura dhe kur të shkon të japësh deklaratë thuaj se ishte ai.*

Qerimi janë parë nga policia në urën e Sllatinës në rrugën për në Tetovë duke ardh nga drejtimi prej vendit të krimit.

Për më shumë hollësi, Besnik Hasani ka deklaruar si më poshtë:

- Më 27 shtator 2007 Shpend Qerimi ka kontaktuar me te diku rreth orës 18.00-20.00 duke e pyetur për mbiemrin dhe numrin e telefonit të vajzës së quajtur Behare (e cila ishte e përfshirë në hetim të cilin ai ishte duke e kryer);
- Ai i ka dërguar mbiemrin përmes SMS-it te Shpend Qerimi;
- Shpend Qerimi i ka kërkuar që të takohen në mbrëmjen e njëjtë dhe ata janë takuar në restorant Ida në ora 22.00;
- Para takimit me Shpend Qerimi, aty rreth orës 21.00 ai ka provuar (të mos shërbej) që të thërras I.D. (alias "Toger") me qëllim të kërkimit të dëmshpërblimit të shumës prej 1000 Euro, të cilat I. ja kishte atij borxh;
- Gjatë takimit të tyre pasues Shpend Qerimi i ka kërkuar të i marr hua 200 euro për disa punë rinovuese;
- Për këtë arsye, pak minuta para mesnatës ata kanë dal prej restorantit dhe janë drejtuar për te I.D. për t'i kërkuar atij parat;
- Në restorant ata janë takuar me A.D. dhe A.A.. Besnik Hasani e ka pyetur A. D. nëse I.D. ishte në shtëpi dhe nëse Afeti mund të i shoqëronte ata. Një kërkesë që Afeti e ka refuzuar për shkak të marrëdhënieve personale me I.D.<sup>20</sup>;
- Me qëllim të arritjes te I.D. ata kanë marrë këtë rrugë: *"Posa ta kaloni Manin është një rrugë që ju dërgon për në Kaçanik dhe ktheheni në të djathtë kah Fusha e Pajtit për në drejtim të Brezovicës. Te kryqëzimi i flamurit rruga ndahet, njëra të dërgon për në Brezovicë kurse tjetra për në Tetovë. Te kryqëzimi i flamurit unë jam kthyer për në drejtim të Tetovës"*
- Ai nuk ishte i sigurt për kohën kur ka dal nga restorant Mani dhe ka mbërri te shtëpia e I.<sup>21</sup>;
- Menjëherë pas daljes nga restoranti Mani, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi janë drejtuar tek shtëpia e I.D.t, që gjendet në mëhallën e Dalloshëve. Ky fshat gjendet në rrugën për te ura e Lepencit dhe ura e Sllatinës.
- Ata kanë ndjekur rrugën Ferizaj/Kaçanik pastaj janë kthyer në të djathtë tek udhëkryqi i fabrikës Silkapor dhe posa kanë mbërri te vendi i quajtur Udhëkryqi i Flamurit, ata janë kthyer në të majtë në rrugën që të qon për në kufi me Maqedoninë dhe eventualisht në Tetovë. Posa kanë arrit te ura e Sllatinës ata janë kthyer në të majtë dhe kanë vazhduar në rrugën Soponica deri sa kanë mbërri në shtëpinë e I.D.t në lagjen Dalloshi;
- Posa kanë mbërri te I.D., Besnik Hasani ka dal nga vetura kurse Shpend Qerimi ka qëndruar në veturë. Ai ka thirrur I.D.n i cili menjëherë ka dal jashtë, edhe një

<sup>20</sup> Gjatë rrjedhës së marrjes në pyetje në seancën kryesore (2.11.2010) Besnik Hasani është përballë me deklaratat e tij të dhëna para prokurorit publik ku ai ka harruar të deklaroj se ai ka qenë në restorant Mani dhe ka biseduar me A. D. dhe A.A.n.

<sup>21</sup> Për kohën e daljes së Besnik Hasanit nga restoranti, Bujar Baftiu ka deklaruar se ai dhe Shpend Qerimi kanë dalë rreth 20 minuta para mesnatës, dhe në asnjë mënyrë nuk kontestohet se i pandehuri ka dal nga restorant Mani para viktimave. Në të njëjtën kohë, është e vërtetuar (duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve R. M. dhe N. A.) se Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi janë përgjuar nga policia në urën e Sllatinës në rrugën e tyre prej rrugës së Soponicës në mes të orës 12.16 dhe 12.21 (d.m.th rreth një minutë pasi që patrulla e policisë ka pranuar alarmin nëradio).

herë është kthyer brenda për t'i marrë paratë dhe pastaj i ka dorëzuar Besnik Hasanit një kartëmonedhë prej 500 Eurove;

- Pas kësaj Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi janë kthyer sërish në të njëjtën rrugë;
- Pasi kanë udhëtuar për një kilometër, në urën e Sllatinës, Besnik Hasani është ndalur nga patrulla policore e R. M. (ashti si shihet më lart, koha e saktë nga takimi i papritur në mes të veturës së të pandehurve dhe të R. M. është në mes të orës 12.16 dhe 12.21.

### 3.1.1.2. Pjesa e pakontestueshme e deklaratave të R. T.

Çka mund të përfundohet nga deklaratat e R. T.? Vlerësimi i tyre duhet të bëhet duke marrë parasysh disa kritere: besueshmërinë personale të dëshmitarit (p.sh nëse janë ngritur elemente konkrete gjatë gjykimit duke treguar atë si të anshëm ose jo të besueshëm), struktura e brendshme e deklaratave dhe elementet jothelbësore të pohimit. Është një thelb i deklaratave të R. T. të cilat janë të pakontestueshme nga palët, dhe në veçanti janë:

- o Disa minuta pas mesnate R.T. ishte te Ura e Lepencit së bashku me X. T.;
- o Te ura ai i ka pa dy persona të cilët sapo dolën nga një veturë me ngjyrë metalike të hirtë veturë Audi (modeli A4 ose A6). Një veturë e tillë i kishte tejkualuar ata para 100/200 metrave, përpara shkollës Provaliu;
- o Njëri nga këta personat ishte biond dhe me flokë të shkurta dhe kishte të veshur një xhaketë të zezë dhe mbante një objekt të gjatë (më pas e identifikuar si armë automatike). Ky person i parë ishte i pozicionuar afër grumbullit me rërë që ishte në anën e djathtë të urës<sup>22</sup>. Gjatë seancës dëgjimore dëshmitari ka mundur të tregoj pozitën e personit të parë në fotografinë e prezantuar në dosjen nr.5 të kësaj dosje, fotografia e bashkangjitur në raportin e policisë të datës 28.09.2007, e shënjuar me shkronjën A; mund të vërehet se grumbulli i rërës është i ngjitur për rrugë në anën e saj të djathtë dhe se distanca në mes të atij grumbulli me rërë dhe spektatorit biond ishte afërsisht një metër (shih fotografinë me shenjë "A" dhe fotografinë paraprake);
- o Personi tjetër i vërejtur nga R.T. ishte në një distancë më të madhe duke qëndruar afër një rrethoje të drurit, i pozicionuar në pjesën e fundit në të djathtë të një hapësirë ku ishte i vendosur grumbulli i rërës;
- o Pak minuta pasi që R.i dhe X. kanë kaluar urën, kanë ndodhur gjuajtjet me armë.

Trupi gjykues është i bindur se tregimet e lart përmendura, në pjesën më të madhe përputhen me deklaratat e X. T., është i besueshëm. Më në përgjithësi, tregimi i R. T. të ngjarjeve të datës 27.9.2007 është gjatë gjithë marrjes në pyetje, i qëndrueshëm, përveç mospërputhjes së veçantë si atë me identifikimin e Shpend Qerimit.

### 3.1.1.3. Besueshmëria e deklaratave të R. T.

<sup>22</sup> Gjerësia e rrugës arrin dy herë sa një veturë mesatare. Kjo është sqaruar me verifikimin e disa fotografive të bashkangjitura në dosjen e rastit( raporti i policisë në vendin e krimit). Ato fotografi e tregojnë shumë qartë grumbullin e rërës të cilën i referohet edhe R.T..

#### **a. Personaliteti i dëshmitarit.**

R.T. është një burrë i cili në kohën e ngjarjeve ishte i moshës 20 vjeçare. Ai nuk ka ndonjë nivel të veçantë të arsimit, por megjithatë ai ka treguar nivel të mirë të zhvillimit mendor, aftësi të mirë të kuptoj domethënien dhe pasojat e deklaratave të tij dhe aftësinë të dalloj në mes të që ai e kupton drejtpërdrejt dhe se ishte vetëm rezultat i supozimit.

Më tutje kjo është konfirmuar nga se si R.T. kishte mundësi të kthehej mbrapa prej pjesës së deklaratave të tij në të cilën e ka identifikuar Shpend Qerimin. Duke vepruar kështu ai ka treguar aftësi të dallueshme logjike dhe dialektike.

Nuk janë bërë evidente asnjë element gjatë marrjes në pyetje të R. T., duke sugjeruar ndonjë lloj defekti në kujtesën e tij apo aftësinë e tij për të kujtuar gjëra dhe t'i paraqes ato.

Është e vërtetë se dëshmitari ka treguar një shkallë të lartë të stresit gjatë gjyqimit. Kjo, megjithëse, është për tu vlerësuar për presionin shumë të lartë që dëshmitari është përballë gjatë një viti e gjysmë, dhe pozicionit të tij ndaj dy palëve, familjeve të viktimave dhe familjeve të të pandehurve (më vonë ka pasur kërcënime të mëdha, ashtu si do të tregohet më poshtë).

#### **b. Struktura dhe koherenca e brendshme e deklaratave të R. T.**

Trupi gjykues mendon se deklaratat e ndryshme të R. T. – përveç pjesëve të tyre në lidhje me çështjen e identifikimit të vrasësve, në të cilën do të arsyetohet më poshtë – janë koherente dhe të logjikshme.

Së pari, prania e disa aspekteve të pakontestueshme të rrëfimit vërtetojnë besueshmëri të përgjithshme të dëshmitarit.

E dyta, stili i rrëfimit dhe prania e një numri të të dhënave të dukshme, të vërtetuara nga dëshmitarët e tjerë (moti në atë natë, koha e gjuajtës, lloji i armës së përdorur), janë simptoma të besueshmërisë. Dëshmitari i rrejshëm, si rregull i përgjithshëm, më tepër si i përgjithshëm në deklaratat e tij, me ato hollësi janë subjekt të kontestimit të mundshëm dhe ato mund të harrohen dhe/ose hedhën poshtë nga i njëjti dëshmitar në deklarata pasuese.

E treta, R.T. ishte në gjendje të vërtetoj qëndrueshmëri në pesë raste në përshkrimin e ngjarjeve të natës kritike. Vlen të shënohet se pesë marrjet në pyetje njëra pas tjetrës në një interval kohor prej më shumë se tri vite.

Sa i përket çështjes së identifikimit të Shpend Qerimit:

- Në deklaratën e tij të parë në polici (20.11.2007) ai ka deklaruar se nuk do të mund të identifikonte personin dhe se ka mundur a shoh vetëm nga ana e pasme. Ai ka konfirmuar, megjithatë, se personi ishte biond dhe me flokë të shkurta.
- Në deklaratën e dytë dhe të tretë (shkurt 2008 dhe mars 2009) dhe me rastin e seancës kryesore në lidhje me bombën në bulevardin Klinton (aktgjykimi ishte siguruar për dosjen e rastit) R.T. ka deklaruar se ishte në gjendje të identifikonte Shpend Qerimin.
- E fundit, në seancën kryesore të tanishme ai ka hedhur poshtë identifikimin.

Trupi gjykues shënon:

- Se përveç çështjes lidhur me identifikimin e Shpend Qrimit, deklarata tregojnë një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe kryesisht nuk janë kontestuar nga palët apo të konfirmuara pjesët tjera të provës;
- Se ka sqarime të arsyeshme për faktin se në rastin e intervistës së parë para policisë, R.T. ka deklaruar se nuk do të mund të identifikonte personin te ura. Në të vërtetë:
  - Më 20.11.2007 gjatë rrugës për në policinë e UNMIK-ut, ai ishte paralajmëruar nga xhaxhai (daja) i X. T. (që udhëtonte me te) që duhej të ishte i kujdesshëm që të mos deklaroj kundër askujt, me qëllim që të mos bie në rrezik;
  - Intervista e parë e R. T. ka ndodhur *para* takimit në City Bar në Ferizaj, kur ai sërish e ka parë Shpend Qerimin. trupi gjykues pajtohet se fakti i të pamurit edhe një herë personin e urës ishte një shtytje e dallueshme e mekanizmit të memories me rastin e intervistimit të vazhdueshëm nga policia me renditjen e fotografive.
  - Me rastin e intervistimit të para nga policia më datën 20.11.2007 dëshmitarit nuk i është treguar ndonjë fotografi gjithashtu sepse edhe emir i Shpend Qrimit, si një nga të dyshuarit, nuk kishte ardh ende;
- gjithashtu ka sqarime të arsyeshme për kthim mbrapa të vazhdueshëm të R. T., të identifikohet për kërcënimet serioze që ai ka pranuar nga familjet e të pandehurve, meqë më poshtë do të shpjegohet më mirë.

### **c. Mos ekzistenca e arsyeve për akuzime të rrejshme nga R.T..**

Është rregull i përvojës së përgjithshme se sa më serioze është vepër penale, më i ashpër është ndëshkimi, më e fortë duhet të jenë motivet që të akuzosh një person në mënyrë të rrejshme ti ketë kryer atë. Kjo është në vëmendje të pasojave shumë të larta për të dy, edhe për personin e akuzuar dhe për dëshminë e rrejshme (i cili do të paraqiste vetveten në shpagim nga i pandehuri).

Tani, mbrojtja nuk kishte mundësi të tregonte arsye të mjaftueshme për R. T. (i cili nuk kishte marrëdhënie me familjen Baftiu e as me të vdekurit) që të dëshmoj rrejshëm kundër të pandehurve, e kështu ta vë në rrezik sigurinë e tij dhe familjen e vet. Vetë R.T. nuk ishte i zhurmshtëm që të shprehte arsye të mjaftueshme që rrejshëm të akuzonte Shpend Qerimin. Përveç faktit se ai ka pasur interesimin më të madh, dhe ishte në një pozitë më të mirë që trupin gjykues ta pajis me arsye të besueshme për kthimin mbrapa të tij nga versioni origjinal (në të cilin ai kishte akuzuar Shpend Qerimin të ketë qenë në urën e Lepencit). Nuk mund të ketë kërcënim të rëndësishëm që mund të i mëveshët gjoja të përvetësuar nga familjet e viktimave me qëllim që ta bindin atë e të dëshmoj kundër të pandehurve. Në të vërtetë, asnjë person me personalitet mesatar (apo edhe më i dobët) do të kërcënohej seriozisht nga fakti – i supozuar nga R.T. – nga dikush që thjeshtë e “*urdhëron*” atë që të akuzoj rrejshëm të tjerët për vrasje; apo thjeshtë të ketë “*dal nga restoranti*”.

Në dëshminë e tij para trupit gjykues R.T. ka pyetur për natyrën e kërcënimit të supozuar, që hutueshëm është përgjigj se ai thjeshtë nuk e di dhe nuk mund ta di.

#### **d. Kërcënimet e familjeve të të pandehurve kundër R. T.**

Ndonëse nuk ka ndonjë dëshmi të kërcënimit apo premtimit që vije nga ana e familjeve të viktimave, dosja e rastit përbën dëshmi të mjaftueshme të faktit se R.T. ishte kërcënuar seriozisht nga (së paku) familjet e të pandehurve Cena dhe Hasani.

Vlen të shënohet se marrjes në pyetje të R. T. në seancën kryesore ishte mjaft i gjallë duke u munduar të zvogëloj nivelin e kërcënimeve të ardhura nga familjet e të pandehurve duke thënë se *“asnjëherë nuk është ndjerë i kërcënuar përderisa është shtyre nga familja Baftiu”*. Gjithashtu ai ka thënë se nuk e ka njohur F. H. (rrethanat qartë e kanë kundërshtuar me deklaratat e F.N.t dhe Ar.B.t dhe në të cilën një procedurë penale është duke u zhvilluar kundër F. H. në gjykatën e Ferizajit). Gjithashtu, nuk është e besueshme dhe e tej-zmadhuar që *“sa herë që ai ka ardh te hoxha në Dubravë (psh. Te Baftiu) ata i kanë dhënë atij para”* (edhe kjo rrethanë është trilluar në tentimin e tij të ofrimit arsyetim të besueshëm për deklaratat e tij kundër të pandehurve dhe për shkak të kthimit të vazhdueshëm mbrapa).

E fundit, nuk është e besueshme se R.T. ka mundur të merr ndonjë kërcënim nga Baftiu me qëllim ta shtyjë atë të flasë kundër Shpend Qerimit vetëm tri ditë pas vrasjes, kur hetimet ishin ende në fazën e hershme e që Shpend Qerimi të konsiderohej si i pandehur. Përkundër çfarë është thënë nga R.T. në këtë nivel, ekzistenca e kërcënimeve kundër tij nga familjet e të pandehurve është dëshmuar përtej dyshimeve të arsyeshme nga dëshmitari i mëposhtëm:

**Ar.B.**<sup>23</sup>.

<sup>23</sup> Deklaratat e gjykimit të 13 korrikut 2010: *“R.i na ka thënë se ai ka pasur një telefonatë nga F.H. dhe të takohen te Euromiti, po i referohem fjalëve të R.it. Ai na ka thënë neve se e ka takuar Florimin diku te ky Euromiti por kur R.i ka hyrë në atë vend ai nuk e njihje F. me fytyrë prandaj u dashtë që ta thërras në telefon deri sa ishte në Euromiti. Simbas këtyre fjalëve përderisa R.i provonte ta thërriste F. ne telefon, ai i afrohet atij dhe i ka thënë Unë jam F.. A je ti R.i? R.i e pohoi. F. i thotë R.it a e di se çfarë lloj deklarate ke dhënë? R.i i tha po që i kam parë dy persona duke dal nga vetura Audi dhe F. i tha se e di çfarë ke thënë sepse unë e kam deklaratën tuaj brenda në veturën time por ti duhet ta tërheqësh deklaratën tuaj. R.i i tha se ai kurrë nuk e ka njohur Besnik Hasanin. F. i tha se e di arsyen pse ti ke thënë atë në lidhje me Shpendin por e di se vëllai im është në të njëjtin rast dhe për këtë shkak ti duhet ta tërheqësh deklaratën. Familja e Neshatit e ka tërhequr deklaratat, ashtu e kanë bërë edhe B. dhe A. e ju çka po pritni. Prej asaj dite R.i është ndjerë shumë keq por ai më ka thënë se për këtë krejt faji është i gjykatës sepse ata e kanë bërë dëshmitar publik dhe ai më ka thënë kush do të më mbroj tash mua? Unë i thash se Zoti do të të ndihmoj ty, as unë e as policia nuk mund ta bëjnë këtë, ju keni parë diçka dhe ju keni thënë vetëm të vërtetën. Ditën e njëjtë që ai ka thënë se është kërcënuar unë i kam thënë se duhet të shkoj dhe raportoj këto kërcënime. Ai më ka thënë se do ta bëjë por se nuk kishte kohë, por kur unë e kam parë më 28 dhjetor ai dëshironte që unë të shkoj në ZPSK dhe raportoj këto kërcënime. Ai më tha se nuk mund të shkoj vetëm sepse kam shumë probleme por ai tha se unë duhet të them atë çfarë ai më ka treguar mua. Më 29 dhjetor unë kam shkuar në ZPSK dhe e kam dhënë të njëjtën deklaratën ashtu sikur edhe sot dhe betohem në gjakun e djemve tanë se po e them fjalë për fjalë atë se çfarë R.i më ka thënë mua.*

...

*Prokurori publik: A mund të na thoni se çfarë lloj kërcënimi ka marrë R.i, a mund të na thoni më në hollësi për llojet e kërcënimeve?*

*Ar.B.: Ai i ka thënë atij të tërhiqet me deklaratën e tij sepse ty kjo do të kushtojë. Edhe nëse ZPSK apo policia ju dërgojnë jashtë shtetit unë do të ju gjej kudo që të jeni.*

*Kryetari i trupit gjyqës: diçka tjetër që është përdorë si kërcënim kundër R.it?*

*Ar.B.: Këto gjëra.*

*Prokurori publik: A mund të ia përkujtoj atij?*

**M.G.:** ishte një polic ndërkombëtar i cili ishte ftuar të ndihmonte në rastin e dëshmisë së R. Tushës gjatë gjykimit për rastin e quajtur “Bomba në rrugën Clinton” kundër të njëjtit të pandehur. Më 21 gusht 2009 ai e ka takuar R. Tushën në një restorant në komunën e Kaçanikut. Vendi ishte caktuar nga R.T. i cili nuk ndjehej mjaft rehat që t’i pranoj policët në shtëpinë e tij. M.G. e ka vërejtur se R.i ishte mjaft i brengosur sepse vazhdimisht shikonte përreth. R.i i ka shpjeguar M.G.t se ishte i brengosur për shkak të faktit se ai kishte telefonata nga një numër i panjohur dhe sepse ishin në mëngjes, vetëm para pesë orëve përmes kushëririt të tij ai kishte pranuar një mesazh nga babai i njërit të pandehurve duke e njoftuar atë se nëse është paraqitur në gjykatë, shtëpisë së tij do t’i vihet zjarri. R.i gjithashtu ka folur edhe për kërcënimet që ka marrë përmes telefonit të cilat kishin filluar shumë më herët. Gjatë këtij takimi i pranishëm ishte edhe një person tjetër (*njeriu i fesë*)<sup>24</sup>.

Deklaratat e dëshmitarit G. janë të besueshme. Një polic ndërkombëtarë, nuk ka lidhje me asnjë nga palët. Ai nuk ishte i përfshirë në hetim dhe ai thjeshtë ka vepruar në përkrahje/mbrojtje të R. T. kur ai ishte ftuar të dëshmoj.

**F.N.:** Sasia e informatave të dhëna nga ky dëshmitar është shumë e rëndësishme. N. është hoxhë në xhaminë e Dubravës dhe gjithashtu është mik dhe i besueshëm i R. T.. Njohuria e tij me faktet rrjedh nga shoqërimi i shpeshtë me R. T. dhe fakti se ai ka përfunduar duke e dëgjuar atë disa herë në lidhje me shqetësimet e tij për hetimet në vazhdimësi. Në qershor të 2009 para fillimit të kërcënimeve kundër R. T., N. më vonë ka treguar se ai ka qenë dëshmitarë i disa prej ngjarjeve të 27 shtatorit 2007. Ai e paraqiti F.N.n me përshtkrim të plotë të ngjarjeve si më poshtë.

- Sa për kërcënimet e marrura, F.N. ka deklaruar se në disa raste R.T. i ka thënë atij se ai po merrte kërcënime serioze nga familjet e të pandehurve me qëllim të bindjes së tij për të mos dëshmuar kundër tyre. Në veçanti, R.T. ka përmendur se F.H., vëllai i Besnik Hasanit, e ka kërcënuar atë seriozisht. Pasi që familja e tij ishte vënë në presion nga familjet e të pandehurve, R.T. ka vendosur të takohet me F.H.n, i cili ka kërkuar që të takohet me atë te pompa e benzinës Euromiti. F.H. përdorte fjalë të buta dhe ka filluar të inkurajoj R. Tushën për jetën e tij dhe pastaj i ka thënë: “*Vëllai im Besnik Hasani do ti vuaj 25 vite në burg për shkak të fjalëve tua. Ti je i ri dhe nuk ke nevojë të merresh me këto punë. Nëse ju e ndërroni deklaratën tuaj do të thotë se vëllai im do të lirohet dhe askush nuk do të kërkoj ndonjë përgjegjësi nga ti*”. F.H. i ka thënë R. T. që të mos “*i merr përgjegjësit e dikujt tjetër në shpinë të tij*” dhe mos t’i “*merr telashet e dikujt tjetër*” F.H. ka provuar të joshë R. T. duke i ofruar atij mundësinë që të mbush benzinë pa pagesë në pompën e Lutfi Zharkut. Në fund, H. ka filluar ta kërcënoj R. T. duke i thënë se nëse nuk i përmbahet me kërkesën e tij do ta gjente kudo që ai të shkonte.

---

Kryetari i trupit gjykues: Pa.

...

*Prokurori publik: edhe nëse gjykata ju mbron juve, nëse ata ju qesin përtej shtetit si dëshmitarë i mbrojtur, unë kam leje qëndrimi në Gjermani dhe unë do të gjej kudo në botë, edhe nëse ty nuk të gjej, do ta gjej familjen tuaj”.*

<sup>24</sup> Të identifikohet me F.N.n: shih më poshtë.

F.N. ka deklaruar se ai e ka këshilluar R. T. që gjithmonë ta thotë të vërtetën para prokurorit dhe të i raportoj kërcënimet e marra. Ai ka aranzhuar takimin në mes të T. dhe prokurorit në të cilin përfundimisht R.T. ka vendosur që mos të vijë. F.N. këtë e ka vërtetuar duke i treguar trupit gjykues SMS-in e pranuar nga R.T. më 186 janar 2010 në ora 11:25. SMS-i i është treguar trupit gjykues dhe ishte kështu: *“Hoxhë po të betohem në Zot nuk mund të them atë çfarë ti me ke thënë të bëj por gjithashtu i thuaj atyre se nuk mundem ta rrezikoj jetën time”*.

- Përfundimisht prokurori ka aranzhuar një lloj mbrojtje të dëshmitarit duke e dërguar te ai një patrullë të policisë. Trupi gjykues shënon se vetë fakti se është organizuar mbrojtja nga policia për R. T. vetvetiu e vërteton ekzistencën e kërcënimeve serioze kundër R. T.
- F.N. gjithashtu ka dëshmuar një takim shqetësues në mes të R. T. dhe dy anëtarë të familjes Baftiu (takimi është konfirmuar gjithashtu edhe nga Ar. dhe N. B.). Në këtë takim të mbajtur në veturë tek varrezat e Martirëve dhe jo në ndonjë kafene, me qëllim që të mos shihen nga familjet e të pandehurve, R.T. ka fol në mënyrë emocionale me Baftinjët duke i thënë se ai ka marrë një telefonatë nga F.H. i cili ka kërkuar të takohet me të. Gjithashtu ai ka thënë se ai dhe familja e tij kanë pranuar presion të madh nga familjet e të pandehurve me qëllim të ndryshimit të deklaratave.
- R.T. i ka thënë F.N.t se F. O. ju ka afruar (diku në korrik 2009) i cili ishte dërguar nga familja Cena dhe është dërguar në Prishtinë në zyrën e avokatit. Aty ai e ka takuar Nysret Cenën, F.H.n dhe dy persona tjerë. R.T. ishte habitur. Avokati i ka thënë të tregoj atë çfarë kishte deklaruar në zyrën e Prokurorit Special dhe i ka thënë të mos dëshmoj kundër të pandehurve, dhe se ajo do të i tregoj atij çfarë të deklaroj.
- Gjithashtu F.N. ka dhënë një konfirmim të plotë të deklaratave të dëshmitarit M.G. i cili ka qene i pranishëm në takimin me R. T. në gusht të 2009.

Trupi gjykues mendon se deklaratat e F.N. janë të besueshme.

Ato janë të përputhshme duke i dhënë disa hollësi gjalla duke u bazuar në frekuentimin e qëndrueshëm të R. T. Marrëdhëniet në mes të R. Tushës dhe F.N.t ishte e bazuar në miqësi por edhe në faktin se F.N. ishte një njeri i fesë dhe si i tillë është mirë i besueshëm që të ketë mundur ta marr besimin e R. T.

Përveç konfrontimit serioz prej avokatëve mbrojtës, i cili e ka marrë në pyetje gjatë, ai nuk ka pasur ndonjë kontradiktë dhe ka pasur mundësi të jep përgjigje të duhura dhe të hollësishme.

Asnjë fakt, nga pikëvështrimi personal, nuk ka mundur dukshëm ta thyej besimin e F.N.t që ishte vërë nga palët. Në veçanti, ai nuk ka farefisni me asnjë prej familjeve të palëve dhe se njohja e tij me R. T. nuk mund që vetvetiu të merret si simptomë e pabesueshmërisë, në mungesë të treguesve specifik nga kjo.

Ai kishte mundësi të vërtetonte dëshminë e tij me prova të dokumentuara: ai trupit gjykues i ka ofruar SMS-in e R. T. (e shënuar më lart) në të cilin ky i fundit i manifestonte brengat e veta në lidhje me sigurinë e tij personale për shkak të presioneve nga familjet e të pandehurve.

Trupin gjykues ai gjithashtu e ka pajisur me CD ROM i cili përbënte në incizim të bisedës telefonike në mes të tij dhe R. T., në të cilën gjoja se R.T. ka marrë kërcënime. Kualiteti i incizimit nuk lejonte kuptim të mjaftueshëm të përmbajtjes së bisedës.

#### **e. vërtetimi i dëshmitarëve për deklaratat e R. T.**

Ashtu si do të vërehet edhe më poshtë, para se R.T. të merrej një pyetje nga policia ai i kishte thënë disa personave në lidhje me ngjarjen te ura e Lepencit. Ai i kishte thënë edhe për personin që e kishte parë te ura dhe për mundësin e identifikimit të atij personi.

Trupi gjykues është i mendimit se fakti që R.T. para se të takohej nga policia ai tashmë kishte dhënë përshkrimin e fakteve njëkohësisht me rrëfimin të bërë më pas te zyrtarët e hetuesisë, tregon se atë çfarë ai e ka thënë pastaj te hetuesit është e besueshme. Më në veçanti:

**i. X. T.** ka konfirmuar të shumtën e ngjarjes të R. T. në lidhje me ngjarjen e datës 27.9.2007. Në veçanti, se ai dhe R.T. rreth mesnatës të asaj nate kanë ecur prej varrezave të Martirëve deri te ura e Lepencit dhe se aty i kanë parë dy persona duke pritur pasi që ata kanë dal nga vetura e tipit Audi, A4 ose A6. X.T. ka thënë se nuk kishte mundësi ta identifikonte personin te ura por se njëri prej tyre kishte flokë të shkurta të bardha dhe kishte veshur një xhakëtë të zezë.

**ii.** Disa dëshmitarë (**A. , I., H., M.B.**, të gjithë të afërm të viktimave) kanë thënë se para se të dyshuarit të viheshin në shenjë për hetim, R.T. i kishte thënë atyre në lidhje me ngjarjen e 27.9.2007 (dhe në veçanti se R.i ishte te ura, dhe se dukshmëria ishte shumë e mirë për shkak të ndriçimit të hënës, se ai kishte parë dy persona te ura, njërin prej tyre në fytyrë dhe se atë person do të mund të identifikonte edhe pse nuk e dinte emrin e atij personi në atë moment<sup>25</sup>).

Përveç faktit se palët e dëmtuara kanë pranuar gjatë seancës dëgjimore besimit për fajësinë e të pandehurve, trupi gjykues mendon se këto deklaratat, duke i marrë në parasysh së bashku me strukturën tjetër të dëshmimeve, janë të besueshme.

**iii.** Ngjarja tjetër e konfirmuar nga dëshmitarët **K.S. dhe B.B.** vërtetojnë besueshmërinë e identifikimit të Shpend Qerimit nga R.T..

**B.B.** ka deklaruar se ai ka dëgjuar nga policia se Shpend Qerimi ishte i dyshuari të ketë marrë pjesë në vrasje. Prandaj në dhjetor të 2007 kur ai ka ardh nga Gjermania, ai ka aranzhuar takim me R. T. me qëllim që t'i mundësohet atij që ta shoh personalisht Shpend Qerimin dhe kështu të vlerësoj nëse ai ishte personi që ai e kishte parë te ura e Lepencit në natën kritike.

K.S. (i cili njihej me Shpend Qerimin) i ka ndihmuar atij të aranzhoj takimin në dhjetor pasdite në kafenenë Luboten (e njohur si City Bar) në Ferizaj kur Berati e ka dërguar R. T. Më vonë vjen Shpend Qerimi dhe derisa ai pinte pijen e tij duke qëndruar në këmbë ta banaku, R.T. (i cili ishte ulur në tavolinën afër bashkë me B.B.n) ka mundur ta shoh atë. Pasi që Qerimi ka lëshuar kafenenë, T. i ka thënë B.B.t se ai ishte burri të cilin ai e kishte për te ura e Lepencit.

<sup>25</sup> Babai i moshuar i njërit prej viktimave ka konfirmuar gabimisht se R.T. gjatë ngushëllimeve apo menjëherë pas tyre i ka thënë se Shpend Qerimi ishte personi te ura. Kjo rrethanë e vetme, e cila është qartë e gabuar, në ndriçim të faktit se vetëm tre muaj pas ngjarjes, R.T. a e ka mësuar emrin e Shpend Qerimit nuk mund të mbivlerësohet dhe duhet të konsiderohet si mospërputhje e kujtesës së dëshmitarit (i cili dukshëm i është referuar kohës së mëparshme të identifikimit që R.T. i referohet vetëm më vonë).

K.S. ka dhënë një vërtetim të plotë të lart shënuarës. Ai ishte marrë në pyetje në seancën dëgjimore më 14.9.2010 dhe ishte konfrontuar mjaft me avokatin mbrojtës dhe vetë të pandehurve. Ai ka thënë:

- Se dikur në dhjetor të 2007 B.B. e ka kontaktuar atë dhe ka kërkuar që të aranzhoj takim me Shpend Qerimin (të cilin Berati nuk e njohte);
- Se takimi ishte organizuar në City Bar në Ferizaj kur Shpend Qerimi ka ardh pas K.S.t, B.B.t dhe një personi<sup>26</sup> tjetër të cilin ai nuk e njohte;
- Se B.B. dhe ky tjetri ishin ulur në një tavolinë në kafene, kurse ai dhe Shpend Qerimi qëndronin në këmbë para banakut dhe aty kanë pirë kafe, kanë mbetur në kafene edhe për një kohë të shkurtë (5-6 minuta);
- Se pasi që Shpend Qerimi ka dal, K.S. është ulur me Beratin dhe atë personin tjetër. Sahiti ka fol me zë të ulët vetëm me Beratin dhe i ka konfirmuar se personi që sapo doli është Shpend Qerimi.

Ashtu si mund të vërehet, deklaratat e B.B.t dhe të K.S.t përputhen plotësisht me takimin e Kadriut me Shpend Qerimin në praninë e R. T. ashtu si edhe fakti se menjëherë pasi që ai është pyetur nga B.B. nëse ai person ishte Shpend Qerimi.

Është me rëndësi të shënohet se pjesëmarrja në kësi lloj takimi është konfirmuar edhe nga vetë R.T. gjatë seancës kryesore.

Natyrisht se R.T. në provimin e tij për t'u tërhequr mbrapa prej deklaratave të paraprahe, ka provuar të pretendoj:

- Se nuk ka qenë e vërtetë se ai i ka thënë B.B.t se personi në City Bar (Shpend Qerimi) ishte personi i njëjtë te ura.
- Se, përkundër, ishte B.B. i cili e kishte *urdhëruar* atë të thotë (nëse merret në pyetje nga policia) se Shpend Qerimi ishte personi i cili ishte te ura e Lepencit në natën kritike.

Trupi gjykues pajtohet se ky shpjegim nuk mund të jetë i besueshëm, në të dy aspektet, në ndriçimin e deklaratave tashmë të kontrolluara dhe dëshmitarët e përmendur më lart dhe duke pasur parasysh se nëse në të vërtetë ai ka qenë në vëmendje të familjeve të viktimave (dhe në veçanti të B.B.t) për të trilluar dëshmi kundër të pandehurve, nuk do të kishte nevojë të aranzhohej "dërgimi për peshkim" përsëritës duke e marrë R. T. nëpër restorante përreth duke shpresuar se ai mund të identifikonte veturën e vrasësve apo edhe vetë vrasësin.

Një kësi lloj sjelljeje do të ishte e panevojshme dhe gjithashtu do të ekspozonte dëshmitarin apo mundësin e rritjes së dyshimeve te të pandehurit.

Në të kundërtën, një sjellje e tillë është më e kuptueshme duke pranuar sqarimin të dhënë nga dëshmitarët Baftiu.

Është e arsyeshme (sipas rregullit të përvojës së përgjithshme, më shumë e theksuar në shoqërinë e Kosovës ku tradicionalisht familjet luajnë rol të madh në adresimin e veprave serioze të pësura nga anëtarët e grupit) se ata do të kërkonin dëshmitarin e vetëm të mundshëm për t'i ndihmuar atyre në zbulimin e vrasësve.

Shpend Qerimi u përpoq të pretendojë se K.S. kishte deponuar gënjeshtër kundër tij, sepse donte të marrë hak kundër tij, nga i cili disa vite më parë ai kishte qenë i hetuar për veprat penale të lidhura me drogë, duke u dënuar përfundimisht në pesë vjet burg. Pretendim është jo i rëndësishëm. Së pari, nuk është e besueshme se ka pasur urrejtje të thellë në

<sup>26</sup> Të identifikohet me R. T. në bazë të deklaratave paralele të B.B.t dhe në bazë të faktit që K.S. e ka dhënë në seancë me përshkrim fizik të një personi të tillë është e pajtueshme me atë të R. T.

mes të dyve, sepse faktet tregojnë se, në të kundërtën marrëdhëniet në mes të dyve ishin normale (deri në pikën që K.S. kishte numrin e telefonit të Shpend Qerimi dhe ky i fundit pranoi një ftesë për një kafe nga i pari). Së dyti, K.S. është një i afërm i Besnik Hasanit dhe ai nuk e njeh Nysret Cenën. Kështu që një trillim ndaj tyre nuk do të jetë i kuptueshme.

iv. Edhe F.N. pranoi nga R.T. një përshkrim të hollësishëm të ngjarjeve të 27.09.2007 i cili është në përputhje me versionin e dhënë në prokurori<sup>27</sup>.

E rëndësishmja, rrëfimin e bërë nga R.T. për F.N. (dhe raportuar nga N. tek paneli i gjyqimit), përputhet qartë me përshkrimin e dhënë nga B.B. (si për njohjen e Shpend Qerimit me rastin e takimit në Kefene të qytetit në Ferizaj).

## f. Konkludimet

Paneli gjykon se mospërputhjet specifike në deklaratat e R.T. të cilat i referohen njohjes së të pandehurve (duke përfshirë tërheqjen e tij të fundit për njohjen) gjejnë një shpjegim të arsyeshëm për rrethanat shpjeguar më lart nën a-e. Kjo duhet të lexohet në lidhje me faktin se vetë R.T. i ofroj prokurororit, me rastin e shqyrtimit të marsit 2009<sup>28</sup>, një shpjegim bindës për heshtjen e tij fillestare (në rastin e shqyrtimit të 20.11.2007) në lidhje me kapacitetin e tij për të njohur njeriun te ura Lepenc<sup>29</sup>. Meqë kërcënimet nga familjet e të pandehurve kanë filluar vetëm në vitin 2009, është gjithashtu, e kuptueshme mirë se në muajt e mëvonshëm nga deklarata e parë e 20.11.2007 R.T. u bë më i sigurt dhe i qetë, për këtë u ndihmua edhe nga kontaktet me familjet e viktimave.

<sup>27</sup> Në veçanti N. tha se T. i ka thënë atij se:

- Kah po vinte poshtë rrugës nga Dëshmorëve Varrezat, para se të mbërrinte në urën Lepenc, një makinë Audi arriti i kaloi dhe u ndal në Urën Lepenc. Makinë po vinte nga drejtimi i Varrezave të Dëshmorëve.
- Ishte natën vonë dhe R.T. raportoi se ishte pak i frikësuar. Ajo ishte një natë e kthjellët dhe ai fokusoi dhe pa shoferin, ndërsa makina tejkaloi. Ai kishte ndarë flokët në të dy anët.
- Ata dy persona me armë të gjata dolën jashtë nga makina kur ajo u ndal. Ai tha se ai ishte i frikësuar, kur makina ndaloi. R.T. madje u kujtua se donte të marrte një gur që të jetë i sigurtë. F.N.t nuk i kujtohet nëse përfundimisht R.T. mori gurin apo jo.
- R. R. tha se makina u largua para se ai ti afrohej, duke shkuar në drejtim të fshatit Nikaj.
- Ai i shikoi të dy njerëzit që kishin mbetur në vend me kureshtje, se ishte hera e parë që ai pa ata.
- R.T. i shpjegoi qartë F.N.t se si ai erdhi për të zbuluar emrin e personit të cilin ai e kishte parë në urë në natën e vrasjes. Ai tha se kur i pa në natën kritike ai nuk i njihnte ata. Pastaj ai takoi njërin, për herë të dytë dhe të treta dhe në rastin e tretë ai u tha se emri i tij ishte Shpend Qerimi. Me rastin e takimit të dytë (afër zyrës së postës në Ferizaj) ai u largua prej tij, pasi ju kujtua ta kishte parë atë në natën kritike. Herën e tretë R.T. tha se e ka parë të njëjtin person, kur ai (R.) ishte ulur në Ferizaj së bashku me një anëtar të familjes Baftiu dhe një person tjetër. R.T. konfirmoi se në fillim ai nuk e dinte emrin e Shpend Qerimi: ai vetëm kishte njohur fytyrën e tij, që e kishte parë në natën kritike. Kjo bisedë mes tij dhe R. Tushës kishte ndodhur para fillimit të kërcënimeve kundër R. Tushës.

<sup>28</sup> Deklarata e tillë nuk u përsërit nga ana e dëshmitarit gjatë shqyrtimit kryesor, por ai u përball me të. Ajo jep një shpjegim të besueshëm dhe të arsyeshëm të mjedisit, dëshmitarët u përballën me dhe për faktin se me rastin e marrjes në pyetje për herë të parë ai mund të ketë zgjedhur ta mbante synin mbyllur për atë pjesë shumë të veçanta të deklaratës në lidhje me mundësinë për të njohur të pandehurit.

<sup>29</sup> Dmth. Paralajmërimi me presion i marr nga I. T. që të njëjtën ditë të mos e ekspozoj veten e tij dhe të thotë se ata nuk kishin parë ndonjë gjë

Ja vlenë të theksohet se intervista e parë e 20.11.2007 ndodhi kur R.T. ende nuk pati mundësi ta shoh përsëri, dy herë dhe të njoh Shpend Qerimi në Ferizaj (dikur vetëm dhe një herë në shoqërinë e B. B.).

### 3.1.2. Dëshmit rrethanore kundër të pandehurve

Deklaratat e R.T. nuk janë e vetmja bazë për dënimin e të pandehurve. Elemente të rëndësishme faktike janë siguruar gjatë shqyrtimit kryesor. Sipas mendimit të paneli, ato japin vërtetim të fuqishme për provën dëshmuese.

#### 3.1.2.1. Dukshmëri në natën e vrasjes dhe distanca midis R.T. dhe personave te Ura Lepenc

Është vërtetuar se dukshmëria në natën kritike ishte shumë e mirë pavarësisht nga errësira. Gjithashtu është vërtetuar se R.T. pa nga afër personin te ura. Kjo mbart rëndësi sa i përket besueshmërisë së njohjes bërë nga R.T.. Në të vërtetë, në bazë të deklaratës së R. T. dhe të dokumentacionit fotografik (shih bajnderin nr.5 bashkangjitur në dosjen e rastit), duhet të konstatohet se distanca mes tij dhe personit flokëverdhe në urë nuk mund të ketë arritur në më shumë se gjerësia e rrugës (R.T. po ecte në anën e majtë të rrugës) **plus** një shtesë tre / katër metra (dmth. distanca që ndau cepin e djathtë të rrugës nga vendi ku njeriu flokëverdhe ishte parë<sup>30</sup>. Është e lehtë të theksohet se ky rikonstruksion vizual përputhet krejtësisht me vlerësimin e R. T. sipas të cilit njeriu flokëverdhe ishte në një distancë prej " 5-6/10 metra" nga ai. Fakti që dukshmëria natën në mes të 27 dhe 28 shtator 2007 ishte e mirë, pa re ose mjegulla, u konfirmua praktikisht nga të gjithë dëshmitarët. Hën e plotë ishte e ndritshëm, të konfirmuara zyrtarisht nga Instituti Meteorologjik i Kosovës me kërkesë të trupit gjykues<sup>31</sup>.

<sup>30</sup> Paraqitur si "A" në foto bashkangjitur raportit të policisë, të datës 28.9.2007, bashkangjitur në bajnderin 5 të shkresave të lëndës.

<sup>31</sup>Shih minutat e gjykimit të seancës së 23.6.2010, dëshmitari N.B.: "*Avni Ibrahim: Si ishte dukshmëria gjatë asaj mbrëmjeje?*

*Gjyqtari kryesues: A kishte re, a kishte dal bëna?*

N.B.: *Unë mendoj se bëna ishte e ndritshme, dukshmëria ishte mirë*". Dëshmitari B. R. konfirmon më tej se koha ishte e mirë, pavarësisht errësirës për shka të orëve të vona. Vetëm dëshmitari N.A. pohoi se nuk kishte hënë, por ky pohim është i qartë, në aspekt të të gjitha deklaratave të dëshmitarëve të tjerë dhe të konfirmuar nga Instituti Meteorologjik

Shih procesverbalin e seancës së 17.6.2011, dëshmitari R.T.:

"Gjyqtari kryesues: Si ishte dukshmëria atë natë?

R.T.: *Ishte mot i mirë, ishte edhe dita e hënës, por ishte koha e errët e natës. Ju mund të shihni afër, por jo shumë larg në distancë.*

*Gjyqtari kryesues: Ishte bëna e plotë, apo gjysmëbëna?*

R.T.: *Unë nuk e di, bëna nuk ishte e ndritshme.*

*Gjyqtari kryesues: A ishte bëna e plotë apo gjysmë apo çerek bëna?*

R.T.: *Unë nuk shikova lartë që ta vërej hënën.*

*Prokurori Publik: Mund t'ju kujtoj deklaratën tuaj, në faqe 2, dhënë Prokurorit Publik, ju tha se atë natë dukshmëria ishte e mirë pothuajse ishte gjatë ditës. Nuk kishte shi dhe se mund të shihje një person nga distanca. A është ky version korrekt?*

R.T.: *Po, kejo është e saktë se ishte natën. Unë nuk mund ta bëjë atë ditë.*

*Prokurori publik: A është kejo e saktë, që keni thënë kështu apo jo?*

R.T.: *Nuk mund ta njihja ndokënd nga distanca.*

*Gjyqtari kryesues: Prokurori Publik është duke thënë këtë se para tij më 4 mars 2009 ju thatë se ishte mbrëmje shumë e ndritshme sikur të kishte qenë ditë, nuk kishte re dhe mund të shihet një person nga larg. A është e vërtetë kejo? Kjo është ajo që keni thënë për Prokurorin Publik 1 vit më parë".*

Kuptohet, dëshmitari nuk mund të ipte vlerësim unanimit si me distancën e saktë nga e cila do të kishte qenë e mundur të njoh dikë gjatë asaj nate. Megjithatë, vlerësimi i përbashkët i deklaratave të tyre është përfundimtar sa i përket faktit se kushtet e shikimit ishin të mjaftueshme në mënyrë që të lejojnë një njohje të sigurt. Siç është përmendur tashmë, R.T. gjatë hetimit, pasi ka deklaruar para prokurorit se ishte e mundur që të njoh me siguri të plotë një person gjatë asaj nate, para trupit gjykues u tërhoq nga ky version.

Ky pohim i R. T., pavarësisht nga të qenit në kundërshtim me deklaratat e tij të mëparshme, është pa dyshim, por qartë, i kundërshtuar edhe nga rrethana të tjera, asnjëherë nuk u tërhoq, sikurse për shembull fakti se ai ka deklaruar se mund të dallojë, nga një distancë prej 100 / 200 metra, shoferin e Audi-së i cili, pasi la vrasësit te ura, *doli nga automjeti dhe i dha një vështrim të shpejtë përreth*<sup>32</sup>.

Dëshmitari F.V., i cili ishte në vendin e ngjarjes pas vrasjes, deklaroi se distanca nga e cila do të kishte qenë e mundur për të parë dikënd ishte njëzet metra<sup>33</sup>. Dëshmitari N.A. deklaroi se kishte mjegull (rrethanë, e cila, u mohua me shumicë dërrmuese nga dëshmitarët e tjerë). Të dy këta dëshmitarë, edhe pse, janë oficerë të policisë që mbërritën në vendin e ngjarjes pas vrasjes që u zhvillua: çfarë është më e rëndësishme, ata shkuan me makinë, dhe në pjesën e sipërme të saj, kur ata operuan në vendin e ngjarjes, kishin ndezur ndriçimin artificial gjë

---

Dëshmitari X.T. deklaroi se nuk kishte mjegull dhe konfirmoi se hëna ndriconte.

<sup>32</sup> Kjo rrethanë është pohuar në deklaratën e parë të bërë nga R.T. më 20.11.2007, deklaratë të cilën vetë të akuzuarit mendojnë të jetë më e sakta.

Në mendimin e Panelit, fakti që R.T. nga një distancë e tillë mund të vërente lëvizje të tilla dhe sjelljet e shoferit, është kuptimplotë faktit që nga një distancë shumë më e shkurtër (rreth dhjetë metra), ai ishte në gjendje të dallojë tiparet e fytyrës së personit i cili mbeti në anën e rrugës tek ura.

<sup>33</sup> Shih procesverbalin e gjykimit f 23.6.2010, faqe 11:

*‘Tahir Rrecaj: A ju kujtoben kushtet, dukshmëria gjatë asaj kohe?*

*F.V.: Ishte gjatë natës, unë nuk mund të them distancën e dukshmërisë, por nuk mund të identifikojë qartë një person nga një distancë e gjatë Tahir Rrecaj: çfarë distance mund të ketë qenë?*

*F.V.: Mund të jem gabim, por nuk besoj se distance të ishte më shumë se 20 metra në mënyrë që të identifikohet qartë dikush. Tahir Rrecaj: Jeni duke thënë për të parë një person në 20 metra, ose për të identifikuar karakteristikat e tij të sakta? Prokurori publik: Dëshmitari ka deklaruar të qartë identifikimin e personit.*

*Gjyqtari kryesues: A mund të specifikoni se çfarë nënkuptoni duke thënë se ju mund të identifikoni qartë një person nga 20 metra?*

*F.V.: Unë besoj se prej 20 metrash ju mund të dalloni një figurë njeriu. Megjithatë, kjo distancë nuk do të zbatohet, kur ka të bëjë me identifikimin e karakteristikave të njerëzve. Arsyeja për këtë është se menjëherë pas mbërritjes në vendngjarje ju filloni të mbledhni prova të cilat nuk mund të gjendet ose të dallohet nga 2 metra*

*Gjyqtari kryesues: Le të përiqemi të jemi të saktë. Është ndryshe nëse ju jeni duke punuar natën me drita artificiale, ndërsa është ndryshe nëse ju kishit qenë më parë duke qëndruar në një ambient të errët pa dritë artificiale për një kohë të gjatë, sepse në këtë rast ju përshtaten sytë në errësirë, këto janë reagime fiziologjike të syve të njeriut. Ne jemi të interesuar të dinë se çfarë ishte mundësia e njeriut për të njohur persona të tjerë në atë natë, pasi ka qenë në terr pa dritë artificiale për një kohë të gjatë. Sikur A ishit atë natë në kushte të tilla apo ishtin gjithmonë me drita artificiale?*

*F.V.: Ju faleminderit I nderuar.. Unë i përgjigjem pyetjes duke pasur parasysh kushtet e natyrës, pa ndikimin e dritës artificiale...*

*Gjyqtari kryesues: Por një minutë më parë ju na tha se kishit ardhur në përfundim vetëm për shkak se ju kishit qenë në kërkim të provave në terren: kjo më bën të mendoj se ju ishit duke përdorur një lloj të dritës artificiale, prandaj jam pak i habitur nga deklaratat tuaja*

*F.V.: Unë nuk kërkova prova në vendin e ngjarjes dhe nuk përdora drita. Oficeri im i Policisë përdori atë. Ajo që kam deklaruar është se jo nën ndikimin e dritës artificiale por normale mendimi im është se në atë distancë një person mund të identifikojë një person*

*Gjyqtari kryesues: A ka pasur dritë të hënës’.*

*F.V.: Unë nuk mund ta mbaj mend, por ishte errësirë’.*

shumë e sigurt (dritat e makinave apo elektrikë dore). Kjo nënkupton se vizioni i tyre ishte jo i sigurtë në dukshmërinë e errësirës. Në të kundërtën, R.T. kishte qenë duke ecur në errësirë për disa minuta dhe kështu sytë e tij i ishin mësuar me errësirën. Deklarata e X. T., edhe pse e shkurtër si dhe qëndrimi "ngurrues" i dëshmitarit, përmban pohim të rëndësishëm sipas të cilës në një natë kritike mund të shihej një person nga një distancë deri në 15 metra (e cila është në përputhje me veshtrimin e personave në urë që ishin duke kaluar në anën e kundërt të rrugës. Në fund, paneli vëren se dëshmitarët dhe X. R.T. kishin të pandehurit në pajmje të tyre vizuale për një periudhë të konsiderueshme kohore, që është e nevojshme për qasje të tyre në këmbë nga një distancë prej 100-200 metra.

### 3.1.2.2. Vendndodhja e Shpend Qerimit dhe Besnik Hasanit menjëherë para dhe pas vrasjes

Është e pakontestueshme se në natën e vrasjes, para se të ishte kryer, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi ishin në restorantin Mani ku kishin qenë edhe viktimat. Besnik Hasani gjatë shqyrtimit të tij pranoi se ai u largua nga Restoranti Mani *para mesnatës*. Dëshmitarët M. D. dhe A.A. gjithashtu konfirmuan ngjarjen. Në bazë të dëshmisë së Bujar Baftiut është e mundur të dihet më saktësisht koha e daljes së Besnik Hasanit. Në fakt, ai deklaroi se ata arritën te Restorant Mani njëzet minuta pas tij dhe u larguan nga Restaurant Mani rreth 23,40. Prandaj mund të konkludohet:

- se në natën kritike të pandehurit ishin në një distancë prej rreth tre kilometra e gjysmë nga vendi i ngjarjes, deri në rreth gjysmë ore para se të bëhej vrasja.
- se më pas ata u larguan në drejtim të jugut (pra në të njëjtin drejtim të urës së Lepencit).

Është pranuar edhe nga të pandehurit, dhe konfirmuar nga dëshmia e oficerëve të policisë, se Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi menjëherë pas vrasjes (dmth. rreth 24,20) u vunë re nga policia, ndërsa *largoheshin* duke vozitur nga vendi i krimit, në një distancë rreth 2,2-2,4 kilometra nga vendi, duke vozitur përgjatë rrugës së vetme për largim nga andej.

Të dy rrethanat e mësipërme janë kuptimplote. Të pandehurit gjysmë ore para pritës (pra, me parashikim të mjaftueshme në mënyrë që të organizojnë atë) ishin në afërsi të vendngjarjes dhe po shkoni në atë drejtim dhe, menjëherë pas vrasjes, u ndaluan nga policia duke u larguar nga ai drejtim. Në krye të kësaj, duhet të theksohet se zona përreth urës Lepenc ishte e izoluar dhe se askush nuk është parë nga dëshmitarët duke udhëtuar përreth për shkak të orës së vonë të natës (kjo rrethanë e fundit ka qenë e konfirmuar nga dëshmitari N.B. ).

### 3.1.2.3. Falsiteti i alibisë së ofruar nga Besnik Hasani

Në shqyrtimin kryesor Shpend Qerimi ka vendosur të vetë mbrohet me heshtje. Besnik Hasani në të kundërtën përsëriti alibinë mbojtëse që kishte deklaruar tashmë gjatë hetimit. Detajet e mbrojtjes së tillë janë dhënë më lart. Në mënyrë që të mbështetet alibia mbrojtëse, dëshmitarët A.A., M. D. dhe I.D. janë kërkuar nga ana e mbrojtjes dhe u intervistuan në shqyrtimin kryesor. paneli gjykon se jo vetëm alibi nuk u provua, por doli të jetë e rreme, për arsyet e mëposhtme:

- I.D. nuk ishte në gjendje për të konfirmuar alibinë, as si në kohë, as si në gjoja ditën e takimit të tij me Besnik Hasanin. Ky i fundit, në fakt, edhe pse duke pranuar se ai e njohte Besnik Hasani dhe se kishin qenë disa raste të borxheve të ndërsjella, ishte në gjendje të pohohet se në një mbrëmje të papërcaktuar, në një kohë jo të saktë, Besnik Hasani erdhi në shtëpinë e tij dhe ja kërkoi 500 EUR. Paneli vëren se është jashtëzakonisht e vështirë që ngjarjet e asaj nate të mbesin në kujtesën e I.D.t, pasi që ajo mbrëmje ishte unike. Në të vërtetë, në lidhje me kohën kur gjoja se ai takoi Besnik Hasanin, në një distancë të shkurtër, dy Kallashnikov shkrepnin breshëri plumbash ndaj veturës së viktimave. Për më tepër në mëngjesin vijus, u bastisën shtëpi në lagjen e tij, nga policia në rrjedhën e hetimeve.
- I.D. dhe Besnik Hasani dhanë version të ndryshëm për mënyrën e pagesës. I pandehuri këmbënguli se banknotat që ai ka marrë nga I.D. ishin disa dhe të shumave të vogël, ndërsa I.D. tha se ai i dha Besnik Hasanit vetëm një kartëmonedhë të vetme prej 500 EUR.
- Versionet e Besnik Hasanit dhe e I.D.t gjithashtu dallojnë për shkak të borxhit: pandehuri ka deklaruar se borxhi që rrjedhin nga një kredi që ai kishte bërë për Dalloshin, kurse ky i fundit ka deklaruar se borxhi i tij rrjedh nga një blerje e tullave që ka blerë nga Besnik Hasani. Në krye të saj, Besnik Hasani nuk mund të ishte i saktë se kur është bërë kredia e supozuar për I.
- Koha e ngjarjeve të përfshira në alibinë mbrojtëse ofruar nga Besnik Hasani nuk përputhet me kronologjinë e ngjarjeve që është konstatuar përmes provave gjatë procedurës. Në të vërtetë:
  - Besnik Hasani pohoi se menjëherë pasi ai dhe Shpend Qerimi kishte lënë Restorantin Mani (siç shihet më sipër, në 23,40 të 27.9.2007) ata u drejtuan për në fshatin e I.D.t marrë rrugën Brezovica<sup>34</sup> dhe pastaj duke marrë rrugën e Tetovës në Kryqëzimin e Flamurit<sup>35</sup>. Ai pretendon se kurrë nuk ka ndalur në rrugë. Shkallëzimet në hartat e siguruar në dosjen e rastit bëjnë të qartë se distanca e fshatit Dalloshi nga restorant Mani është, pasuar rrugën e të pandehurve ", është rreth 6 kilometra. Është një rrugë e asfaltuar mirë, të paktën deri në një kilometër para shtëpisë së D.-t. Besnik Hasani padyshim ka qëndruar te D. vetëm disa minuta (2 deri 5), kohë saktë e nevojshme për të që thërret I. dhe për I. t'ia jap atij parat. Shpend Qerimi as nuk ka dal nga makina. Me maturi, duke interpretuar provat në favor të të pandehurve, kohëzgjatja e qëndrimit te D. mund të konsiderohet të ketë qenë 5 minuta. Pas kësaj, ata u larguan menjëherë dhe udhëtuar prapa në rrugën e njëjtë që kishin kaluar për të arritur atje. Policia i pa ata në kryqëzimin midis rrugës Saponica (në të cilën ata po udhëtonin) dhe rrugën e Tetovës<sup>36</sup>, vetëm një kilometër, pasi ata ishin larguar nga Dalloshi. Prandaj, distanca e përgjithshme e mbuluar nga të pandehurit ishte 6 km (nga Restorant Mani deri te Dalloshi) plus një kilometre shtesë (nga Dalloshi prapa në rrugën Tetovë ku policia

<sup>34</sup> Ata morën rrugën e Brezovicës në kryqëzimin e shënuara me numrin 2 në hartë nr. 2.

<sup>35</sup> Kryqëzimi i Flamurit është shënuar me "3" në hartën nr. 2 bashkëngjitur me dosjen e rastit.

<sup>36</sup> Kryqëzim i tillë ishte përmendur nga Besnik Hasani në hartë nr. 1 me numrin "4".

ndaloi ata). Edhe duke supozuar (jorealisht, në konsideratë të cilësisë së mirë të rrugës dhe mungesës totale të trafikut gjatë natës) e shpejtësia mesatare të jetë 50 km / h, do të rezultonte, përmes një operacion të thjeshtë matematike, se koha e nevojshme për të mbuluar distancën e tillë është rreth 8 minuta. Duke ia shtuar kësaj kohën e kaluar në shtëpinë e D. (maksimumi 5 minuta) dhe duke kujtuar se Besnik Hasani u largua nga restoranti në 23,40, do të pasonte në atë se, nëse rrëfimi i tij ishte i vërtet, Policia do të duhej ta ndalonte atë së fundi në 23,55. Kjo është në kundërshtim të qartë me deklaratat e anëtarëve të patrullës policore, të cilat e bëjnë të qartë se vetura e Besnik Hasani u ndalua në mes 00,16 dhe 00,21. Ekziston, me fjalë të tjera, një boshllëk kohor prej 20/25 minutash cila e bën alibinë e dhënë nga Besnik Hasani jo në përputhje me faktet e konstatuara në kuadrin e provave.

- Besnik Hasani pa dyshim nuk e kishte informuar më parë I.D.n për vizitën e tij.  
Paneli gjykon se do të ishte krejtësisht naive për të besuar se i pandehuri ka shkuar tek D. pa e njfotuar , për shkak se:
  - Ishte mesnatë. Kjo sepse mbart rëndësi, më së shumti për shak të faktit që D. kishte një familje me disa fëmijë;
  - Nuk ka qenë situatë emergjente që justifikonë një shqetësim të tillë: as nuk është pretenduar e as provuar, se borxhi i Shpend Qerimit për pagesën e punëve ndërtimore ishte i urgjencës së tillë, që nuk do të ishte e mundur të presë deri në ditën-(t) vijuese.
  - Është vërtetuar se Besnik Hasani kishte një llogari bankare të hapur në Pro Credit dhe se në llogari bankare të tillë ai kishte të holla të cilat do të kishin qenë të mjaftueshme për kredi të dyshuar për Shpend Qerimin. Jo vetëm: banka informoi trupin gjykues që Besnik Hasani ishte i pajisur me një kartë debiti e cila kishte një limit tërheqjen në atë ditë deri në 500 Euro<sup>37</sup>. Pra, pse është dashur që Besnik Hasani të vendos që të udhëtoj natën në lagjen e D. (ku ai as që e ka ditur që sigurisht do ta gjejë I.D.n, i cili nuk kishte qenë i informuar më parë, dhe se kjo nuk ishte pranuar asesi që ai kishte në posedim 500 euro), kur ai mund të kishte tërhequr para nga çdo dispenszer të hollash në dispozicion, në përputhje me deklaratën e bankës, në zonë?
- Deklaratat e A.A.t dhe M. D. (të ciliët thanë se duke e lënë Restorant Mani, Besnik Hasani u kishte thënë atyre se ai po shkonte te I.D.) nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar alibinë, të paktën për këto tri arsye:
  - Një lidhje e ngushtë miqësie mes Besnik Hasani, M. D. dhe A.A. u provua, nga e se ka të ngjarë që dy të fundit mund të kenë bërë një deklaratë të matur;
  - Madje duke pranuar se të pandehurit i thanë D. dhe A. se ata i ishin drejtuar për te I.D., mund të ketë qenë në mënyrë që të sajojnë një mbrojtje të alibise.

<sup>37</sup> Rrethanë është bërë e qartë nga deklaratat bankare të marra sipas urdhërit të trupit gjykues të lëshuar në fazat e fundit të shqyrtimit kryesor.

- Përfundimisht edhe duke pranuar se në natën kritike, të pandehurit kishin vizituar I.D., kjo ende mund të jetë në përputhje kronologjike me kryerjen e krimit. Me fjalë të tjera, është e mundur që Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, para ose pas të shtënave në Urën Lepenc, kanë mundur të kenë ndalur te I.D. në mënyrë që të sajojnë një mbrojtje të alibisë.

#### 3.1.2.4. Motivet

Prokuroria pretendon se vrasjet janë kryer nga të pandehurit për shkak se Neshat Baftiu po thoshte përreth se Besnik Hasani ishte fajtor për bombardimin e Bar Sekiraqa në bulevardin Bill Klinton, që ka ndodhur më 23.9.2007.

Në fakt, procedura e provave konfirmoi se Neshat Baftiu, në ditët menjëherë pas bombardimit u tha disa nga anëtarëve të familjes (të cilët janë marr në pyetje gjatë procedimit të provave) se Besnik Hasani (dhe "grupi i tij") ishin autorët e bombardimit. Çka është e mundur që në një mjedis të kufizuar të tillë si Dubravë dhe fshatrat përreth lajme të tilla kanë të ngjarë të përhapen jashtë rrethit të familjes, dhe të arrijnë në veshët e të pandehurve (të cilit, është e dobishme për ta mbajtur mend, kanë qenë oficerë të policisë, njëri prej tyre me shërbim në Ferizaj).

Kështu që shpjegimi i supozuar nga prokuroria është, sipas mendimit të panelit, më i besueshmi.

Por, prokuroria nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se të dyshuarit me të vërtetë ishin informuar për këto sjellje të Neshat Baftiut.

Megjithatë, paneli ka vërejtur se mungesa e provës së plotë të krimit nuk paraqet ndonjë pengesë për vërtetimin e përgjegjësisë kriminale kundër të pandehurve, sepse pjesa e mbetur e kornizës së provave është solide dhe vendimtare. Për t'i refuzuar motivet e supozuara, mbrojtja është përpjekur të pohojë se disa njerëz të tjerë mund të kenë pasur motiv për ta vrarë Neshat Baftiun.

Kështu ata kanë përmendur (përmes dëshmitarit D.H) njëfarë Q. (i cili supozohet t'i ketë thënë atij se ai e ka vrarë Neshatin), ose disa policë (të cilit mesa duket e kanë kërcënuar Neshat Baftiun disa javë para se ai të vritet) ose pronarët e ndonjë kompanie të cilët supozohet se Neshat Baftiu i kishte shantazhuar, ose personat (të cilët mbrojtja nuk i ka identifikuar në veçanti) të cilit në mënyra të ndryshme e kanë kundërshtuar Neshat Baftiun gjatë përlëshjeve.

Paneli vëren se:

- nuk ka dyshim se Neshat Baftiu ishte një person grindavec, i cili disa herë kishte marrë pjesë në përlëshje, kështu që ka mundësi të ketë pasur disa armiq;
- se mbrojtja, me faktin e thjeshtë duke përmendur dikë që ka arsye të mundshme të urrejtjes kundër Neshat Baftiut, nuk ka treguar asnjë element konkret dhe specifik të fajësisë për vrasjen për të cilën po zhvillohet procedura;
- se asnjëri nga personat të cilit mbrojtja i ka dëftuar si kryes të mundshëm të veprës nuk janë parë në vend të ngjarjes natën kritike.

Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë deklaratave të dëshmitarit D.H. Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.9.2010 ai i kishte thënë trupit gjykues se ai e kishte ditur nga gruaja

e Neshat Baftiut se kishte qenë Q. (i njohur edhe si Kobra), shtetas i Shqipërisë, ai që e kishte vrarë Neshatin

Paneli vlerëson se dëshmia e D. H. nuk është e qëndrueshme për shkak se:

- deklaratat e tij në pjesë të ndryshme janë në kundërshtim me deklaratat që i ka dhënë më herët. Mospërputhjet të cilat ai nuk ka mundur t'i shpjegoj, por të mos thënë arsyetime qesharake.
- informata se Q. është fajtorë për vrasjen e Neshatit u bë e ditur nga Hajrullahu vetëm nga thashethemet e gruas së Neshatit. Trupi gjykues i ka deklaratat e të dytës, e cila ka thënë se ajo nuk ka asnjë ide për autorët e vrasjes së Neshatit (në kundërshtim me atë që ka thënë H.)
- Është vërtetuar se Besnik Hasani e kishte kërkuar H. për një takim në burgun e Dubravës një muaj para se të merrej në pyetje si dëshmitar. Takimi u zhvillua në burgun e Dubravës, pranë shkollës së burgut.

### 3.1.5. Përfundime

#### a. Shpend Qerimi ishte te ura e Lepencit natën kritike në kohën e vrasjes.

Trupi gjykues pajtohet qartësisht se korniza e dëshmimeve drejton kah Shpend Qerimi si njeriun të cilin R.T. e ka parë në urën e Lepencit pak para vrasjes, duke bartur një armë të gjatë.

Së pari, R. T., në deklaratat e tij të shkurtit 2008 dhe marsit 2009, ka mundur ta njoh (në bazë të albumit të fotove) Shpend Qerimin si personi që ishte tek ura e Lepencit.

Kjo që u tha më larët mbështetet me këto gjetje faktike:

- se R.T. kishte parë një person biond, me flokë të shkurtra në vend të ngjarjes pak para vrasjes, diku kah mesnata në natën kritike, bashkë me një person tjetër dukë qëndruar pranë skajit të rrugës të armatosur me armë të gjata. Asnjë person tjetër nuk ishte aty dhe T.t ishte të qartë në deklarinimin e tyre që jo më shumë se dy persona kishin zbritur nga vetura Audi. Menjëherë R.T. e kishte njohur atë njeri si Shpend Qerimi;
- faktin se atë natë veçanërisht dukshmëria kishte qenë e mirë, hëna e plotë me mundësinë që R.T. t'i shihte personat për ca kohë, teksa po ecte në drejtim të tyre nga largësia;
- faktin se vendi ishte i izoluar;
- faktin se rreth 30 minuta para vrasjes Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi kishin pranuar se kishin dalë nga restoranti Mani duke shkuar kah jugu (d.m.th në drejtime të vendi të krimit);
- fakti se menjëherë pas të shtënave (5-10 minuta me vonë) ata i kishte ndalur policia në një distancë prej 3 km, duka ardhur nga drejtimi i vendit të ngjarjes;
- faktin se Besnik Hasani ka dhënë një mbrojtje alibi që është e rrejshme, për arsye që u shpjeguan më lartë;
- faktin se të pandehurit kishin kohë të mjaftueshme të mbërrinin në vendin e ngjarjes, për t'ua zënin pritën viktimave dhe të iknin nga atje.

Logjikisht nuk mund të pranohet çfarëdo konkludimi tjetër.

**b. Besnik Hasani është personi që ishte me Shpend Qerimin tek ura. Me të vërtetë:**

- është vërtetuar se që të dy personat ishin parë nga R. dhe X.T. tek ura, pasi që ishte larguar vetura Audi.
- Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi kishin kaluar së bashku mbrëmjen e datës 27.09.2007. Në fakt, ata ishin parë së bashku pak para të shtënave, si dhe menjëherë më pastaj. Sipër kësaj, Besnik Hasani ka pranuar se ai dhe Shpend Qerimi kishin qenë *gjithnjë* së bashku gjatë asaj nate nga ora 10 në mbrëmje e tutje dhe, në veçanti, që kur ishin larguar nga restorant Mani, e deri kur ishin ndaluar nga patrola e policisë pas të shtënave.
- është vërtetuar se vrasja ishte kryer duke përdorur në kohën e njëjtë të dy AK47.

Nga faktet e më sipërme, del i logjikshëm përfundimi se Besnik Hasani ishte personi i dytë te ura dhe prapë, përsëri, do të ishte vetëm një ushtrim teorik të imagjinohet se dikush tjetër, dhe jo Besnik Hasani, ishte autor i të shtënave.

**c. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi kanë shtënë kundër Neshat, Urim, Sylejman, Bujar dhe Sadik Baftiut te ura e Lepencit.**

Kjo në bazë të këtyre elementeve që dalin nga procedura provave.

- Shpend Qerimi dhe Besnik Hasani ishin së bashku në vendin e ngjarjes;
- Dëshmitarët okularë kanë deklaruar se vetëm dy persona gjendeshin në vendin e ngjarjes pak para të shtënave dhe askush tjetër nuk ishte parë në afërsi;
- Shpend Qerimi ishte parë duke mbajtur një pushkë automatike në dorë, kurse ndihmës i tij po qëndronte në këmbë pak më poshtë nga rruga;
- Dy pushkë automatike ishin shkrepur në të njëjtën kohë (deklaratat e Sadik dhe Bujar Baftiut dhe raporti i krim teknikës i bashkëngjitur shkresave të lëndës);
- Sjellja e të dyshuarve para të shtënave kishte qenë tipike e një prite të dhunshme (ata ishin transportuar dhe zbritur tek vendi i ngjarjes mu në mes të natës, të armatosur me armë të gjata, vetëm 10 minuta para të shtënave, në një vend të izoluar);
- Nuk është e arsyeshme të vlerësohet, përveç nëse formulojmë teori, se të dyshuarit mund ta jenë larguar nga vendi dhe menjëherë persona tjerë të armatosur mund të jenë shfaqur në vend të ngjarjes dhe të kenë kryer vrasjen.

Përfundimi i vetëm logjik i mundshëm është se Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi kishin shtënë me armë.

Kështu duhet të përfundohet se të gjitha elementet e *actus reus* janë të prezent. (veprimi, lidhja kauzale, pasojat)

Lidhur me rrethanat dhe kualifikimet e veprave penale, është e qartë se faktet e cekura më lartë kanë rezultuar në pronësisë ilegale dhe përdorimin e armëve (dy armë automatike kallashnikov) dhe vrasjes së rëndë (të Neshat Sylejmaniit dhe Urim Baftiut).

Në veçanti, trupi gjykues pajtohet se vrasja ishte kryer në një mënyrë tinëzare, duke marrë para sysh se të pandehurit gjatë natës i kishin zënë pusinë veturës së viktimave të cilit as nuk kanë mundur të provojnë të organizojnë një reagim.

Është e qartë se edhe rrethana e nenit 147 par 11 është prezentë në atë që tre persona ishin vrarë në të njëjtën kohë nga veprimet e të dyshuarve të cilit barabar kanë vepruar bashkërisht në kryerjen e veprës penale (kështu duke integruar edhe dispozitën e nenit 23 të KPPK).

Kështu duke vrarë Neshat, Urim dhe Sylejman Baftiun të dyshuarit kanë kryer një vepër penale me shumë vrasje (e që është interpretimi më i mirë i nenit 147 para 1 i KPK-së, në pajtim me kompetencën e Gjykatës Supreme të Kosovës)

Paneli pajtohet, në të njëjtën kohë, se rrethana e nenit 147 para 8 (të cilin prokurori e ka cekur në aktakuzë) nuk ishte vërtetuar, ngase nuk kishte dëshmi të plotë se vrasja ishte kryer që të pandehurit ta fshihnin sulmin me bomba në sheshin Bill Clinton, të kryer më herët.

Rrethana tjetër e nenit 147,9 i referohet ekskluzivisht të pandehurit Nysret Cena dhe prandaj nuk do të diskutohet këtu.

Sa i përket veprave të vrasjes në tentativë, paneli pajtohet se aktet e Besnik Hasanit dhe Shpend Qerimit ishin në mënyrë të qartë të synuara ndaj vrasjes së të gjithë udhëtarëve në veturën Golf 2.

Me të vërtetë, nuk ka dyshim se breshëria e plumbave të shtënë mbi veturë me dy armë automatike Kallashnikov, nga një largësi e shkurtër dhe me veturën duke lëvizur ngadalë, nuk do të thotë tjetër veçse qëllimi i gjuajtësve për t'i vrarë udhëtarët në veturë. Prandaj është e saktë t'i shpallim ata fajtorë edhe për vrasje të rëndë në tentativë të Sadik and Bujar Baftiu.

Sa i përket elementit *mens rea*, dashja e kryesve të veprës penale, në mungesë të pranimit të fajësisë ose dëshmisë me gojë, duhet të kuptohet nga objektiviteti i akteve.

Në rastin konkret nuk mund të ketë dyshime, duke marrë parasysh:

- mënyrën e kryerjes së veprës (shtënia me një pushkë automatike) nuk mund të shpjegohet ndryshe veçse supozimi i ekzistencës së dëshirës për të vrarë;
- organizimi i pusisë duke përfshirë disa njerëz lë të kuptojë doemos dëshirën me vetëdije për të kryer veprën penale.

Me fjalë të tjera paneli çmon se jo vetëm që ka ekzistuar dëshira për të vrarë, por edhe paramendimi për atë veprim.

Në përfundim, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, duhet, për këtë arsye, të ngarkohen me përgjegjësi për vrasjen e Neshat, Urim dhe Sylejman Baftiu dhe për vrasje të rëndë në tentativë të Sadik dhe Bujar Baftiut.

### 3.2. Nusret Cena

Nusret Cena akuzohet për kryerje të veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë në kundërshtim me nenin 147 par 1 nënpar 3, 8 dhe 9 lidhur me Nenin 23 të KPK-së; dy pika të veprës penale të vrasjes së rëndë nga Nenin 147 par 1 nënpar 3 lidhur me Nenin 23 të KPK-së; dy pika të veprës penale të vrasjes në tentativë nga Neni 147 para 1 nënpara 3 lidhur me Nenin 20 dhe 23 të KPK-së, në dëm të Bujar dhe Sadik Baftiut.

Por, pas shqyrtimit të dëshmisë së prezantuar gjatë shqyrtimit kryesor, trupi gjykues është i mendimit se nuk është vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme se ai ka kryer veprat penale të supozuara.

Gjatë shqyrtimit kryesor, Prokurori publik ka paraqitur këto dëshmi:

1. deklarata e dëshmitarit, R. T., të cilin paneli e ka marrë drejtpërsëdrejti duke marrë dëshmitarin në pyetje gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me 18 qershor 2010;
2. Ditarit të hotel Europa;
3. Regjistrimi i thirrjeve hyrëse dhe dalëse nga telefoni i Nusret Cenës.

Më herët, para prokurorit publik, ai ka deklaruar se vetura prej nga zbritën të pandehurit në vendin e ngjarjes *“ishte e tipit Audi dhe këso veture kishte vozitur Nysret Cena. Natën kritike shoferi i veturës Audi kishte ndarë flokët në mes ashtu si Nysret Cena por nuk jam i sigurt se a ishte ai apo jo”*.

Kjo nuk mjafton për të vërtetuar se Nusret Cena ishte duke vozitur veturën prej së cilës kishin zbritur Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi në vend të ngjarjes.

Në të vërtetë, është e qartë nga deklaratat e T. (dhe kjo gjë kurrë nuk ishte hedhur poshtë) se ai nuk e ka njohur Nysret Cenën para të shtënave dhe se ai kurrë se kishte parë veturën e tij. Veçanërisht për këtë arsye familja Baftiu, gjatë ditëve mbasi kishin ndodhur të shtënat, ka pasur nevojë ta sjell atë rreth fshatrave përreth për të parë nëse ai ka mundur të identifikojë ndonjë veturë të ngjashme me atë që ai e kishte parë te ura.

Kjo e bënë të qartë se i tërë interpretimi i fjalisë së R. Tushës *“aso veture kishte vozitur Nysret Cena”* është *aso lloj* veture kishte vozitur Nysret Cena. Me fjalë të tjera, mbasi kishte marrë vesh (ditëve pas vrasjes) se Nusret Cena posedonte një veturë të ngjashme, ai ishte në pozitë t’ia pohojë prokurorit se Nusret Cena kishte vozitur aso veturë. R.T. njëkohësisht ishte shumë i qartë në pohimin e tij se ai nuk e kishte njohur Nysret Cenën në veturë. Kjo, edhe për një arsye tjetër, e bënë të pamundur përfundimin se Nusret Cena ishte personi që voziste veturën natën kritike, as supozimin se vetura e tij ishte ajo që kishte parë R.T..

Përveç asaj çka u tha më lartë, prokuroria nuk i ka ofruar trupit gjykues ndonjë informatë për vendndodhjen e Cenës pas orës 22:35. Vetëm dihet se pas orës 22:35 ai gjendej në një dhomë të hotelit. Mungesa e kësaj prove duhet të interpretohet në favor të pandehurit. Së fundi, nga regjistrimi i bisedave telefonike mund të vlerësohet se Nusret Cena në ora 23:59:55 kishte marrë një mesazh dhe qeliza ID tregon se në atë kohë ai kishte qenë brenda zonës të cilën e mbulon qeliza telefonike Nikaj 1, që mbulon zonën që përfshinë edhe vendin e ngjarjes.

Kjo dëshmi nuk merret si vendimtare. Në të vërtetë, në deklaratën e tij para panelit, i pandehuri ka pranuar se rreth mesnatës ai ishte mësyre për në shtëpi sepse nuk dëshironte të vonohej atë natë për shkak të një takimi të rëndësishëm të biznesit që do të zhvillonte të nesërmen.

Tani, nga harta (nr # 2) që paneli e ka marrë si dëshmi mund të shihet se për të arritur fshatin Doganaj (vendbanimin e të pandehurit) nga hotel Europa, një rrugë e mundshme është ajo që shkon përmes Gabërnice e epërme, që mbulohet nga Nikaj 1, pra e njëjta qelizë ID që mbulon edhe vendin e ngjarjes. Kjo nënkupton se, me gjasë, ka një shpjegim alternativ se telefoni i Cenës ishte brenda kësaj zone të mbuluar nga e njëjta qelizë telefonike, pak minuta para se të ndodhte vrasja. Duhet të shtohet se zona e mbuluar nga qeliza është tepër e rëndësishme, prandaj është e pamundur të dihet saktësisht ku ishte Nusret Cena në këtë zonë.

Bazuar më lartë, paneli përfundon se dëshmitë e paraqitura nga Prokuroria për të vërtetuar përgjegjësinë e tij janë të pamjaftueshme që realisht të vërtetojnë se Nysret Cena ishte pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të cekur në aktakuzë.

### 3.3. Avket Vishi

Avket Vishi akuzohet për posedim të paligjshëm të armëve në kundërshtim me nenin 328 para 1 i KPK-së.

Deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga Prokuroria janë ato të: M.B., H.B., Bujar Baftiu, I. B., A.B., Bl.B., V.B., dhe F.B..

M., H., I. dhe F.B. kanë dëshmuar se Avketi kishte një marrëdhënie të ngushtë me Neshat Baftiun, gjatë periudhës pak para vrasjes së Neshatit.

Dëshmitë më të rëndësishme janë këto të: Bujar, A. dhe Bl.B.t të cilit e kishin parë Avketin bashkë me Neshatin me dy armë automatike kallashnikov.

Veçanërisht:

**3.3.1.** Në deklaratën para panelit, Bujra Baftiu kishte thënë se disa ditë para vrasjes ai kishte takuar Neshatin, i cili i kishte kërkuar atij të shkonin bashkë në malin e Lubotenit për t'i provuar dy kallashnikovë. Bujrai ishte pajtuar dhe kishte pritur që Neshati ta thërriste, por më kot. Të nesërmen pasdite Bujari kishte parë Neshatin duke u kthyer nga mali i Lubotenit. Neshati kishte qenë me Avketin dhe ata kishin dy kallashnikov me vete.

**3.3.2.** A.B., në deklaratën e tij para panelit, kishte thënë se disa ditë para vdekjes Neshati ia kishte huazuar veturën atij për të shkuar në Prishtinë. Kur Neshati ia kishte kthyer veturën Agimit, Agimi i kishte parë dy kallashnikov, dhe ai vetëm i kishte vënë armët në veturën e Neshatit. Edhe Avketi ishte i pranishëm. Neshati i kishte thënë Agimit se aso armë ishin për ta (d.m.th për atë dhe Avketin)

**3.3.3.** Bl.B. (vëllai i Neshat Baftiut, jetojnë në të njëjtën shtëpi) ka dëshmuar para Gjykatës se disa ditë pas vrasjes, Avketi kishte ardhur në shtëpinë e tij dhe i kishte thënë atij se disa armë ishin në ahur. Ai i kërkoi B. t'ia ipte ato atij. Pastaj, B. kishte shkuar në ahur dhe kishte gjetur dy kallashnikov që Avketi ia tregoi, në një çantë, dhe ia dorëzoi Avketit.

**3.3.4.** V.B. i kishte thënë panelit se një shok i rëndomtë – i tij dhe i Avketit – i kishte thënë atij se situata e Avketit po bëhej më e komplikuar për shkak të atyre armëve. V. ishte përgjigjur dukë thënë se për fat të keq ai nuk mund të bënte asgjë për këtë. Ai kishte mësuar për punën e armëve nga vëllai i tij, B.

Në bazë të deklaratave të sipërpërmendura, paneli pajtohet se Avket Vishi ishte në posedim të dy kallashnikovëve, bashkë me Neshat Baftiun para vdekjes së tij si dhe kur ai kishte marrë armët nga vëllai i Neshatit pas vdekjes së Neshatit.

Sipas panelit, të gjitha dëshmitë që paneli i ka marrë janë të besueshme.

Së pari, ato janë koherente nga ana e brendshme, pa zbrastri logjike apo shpërputhje. Narrativi është i detajuar dhe njëri prej tyre në veçanti (Bl.B.) përshkruan marrëdhënien e Avket Vishi me intensitet të veçantë, ngaqë ajo tregon se Avket Vishi kishte mundësi t'i tregonte Bl.B.t se ku ishin të fshehura armët në ahurin e vetë, kurse ky i dyti as që ishte në dijeni për këtë.

Deklaratat e dëshmitarëve përputhen reciprokisht meqë ato vërtetojnë njëra tjetrën në dy aspekte shumë specifike për mbajtjen e armëve nga Avket Vishi: episodi e parë para

vrasjes së Neshat Baftiu (kur ai dhe Avketi kishin provuar armët) dhe episodi e dytë pas vrasjes (kur Avketi kishte rimarr të njëjta armë nga familja e Neshatit).

Procedura e provave nuk ka vënë në dukje ndonjë arsye, çfarëdo çoftë ajo, pse Baftiajt duhej ta kishin akuzuar rrejshëm Avket Vishin. Në të kundërtën, ekziston dëshmi e qatë se Avketi kishte raporte shumë të mira me Neshat Baftiun para vrasjes dhe se ai kishte marrë pjesë në ngushëllime për vrasje të viktimave.

Sjellja e përshkruar nga dëshmitarët (posedim – në bashkëkryerje me Neshat Baftiun – dy pushkë kallashnikov; transportimi i tyre nga vendi i Neshat Baftiut në një vend tjetër të panjohur) dukshëm ngërthen dispozitën e Nenit 328 para 2 të KPK-së sipas pikëpamjes së *actus reus*.

Nuk është e kontestueshme se Avketi Vishi nuk kishte asnjë lloj të autorizimit për përdorimin e këtyre armëve të rrezikshme.

Nuk ka dyshim aty për ekzistencën e elementit *mens rea*. Në të vërtetë, është vërtetuar se posedimi ishte i qëllimshëm. Njëherit, ekziston dyshimi i bazuar se posedimi kishte për qëllim ekzekutimin e hakmarrjes, por prokuroria nuk ka mundur të ofroj prova të plota për këtë gjë.

Kështu Avket Vishi duhet të shpallet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë.

#### 4. Caktimi i dënimit

##### 4.1. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi

Kur të vendos për dënim, gjykata duhet të marrë parasysh mënyrat e kryerjes së krimit dhe personalitetin e të pandehurit. Dënimi duhet të pengoj kryerjen e veprave tjera dhe dënim proporcional për veprën që është kryer.

Aspektet e dhëna më poshtë, Paneli i konsideron si tejet relevante:

- se janë vrarë tre persona të moshës së re dhe një tjetër është lënduar seriozisht
- se janë konstatuar dy rrethana rënduese.
- se faktet e rastit tregojnë që vrasja ishte paramenduar me saktësi: është e qartë se kjo ka kërkuar planifikim dhe vëzhgim në mënyrë që të pandehurit ta dinin se nga do të kalonin viktimat
- procedura e provave tregon se të pandehurit me saktësi kishin zgjedhur rrethanat e kohës dhe vendit me qëllim që më mirë t'i realizonin synimet e tyre vdekjeprurëse. Në të vërtetë, ishte konstatuar se para urës së Lepencit ishte e nevojshme që veturat ta zvogëlonin shpejtësinë për shkak të cilësisë së dobët të asfaltit, kështu duke e bërë më të lehtë që pritarët ta qëllonin cakun e tyre.
- Të pandehurit kishin vepruar në bashkëkryerje duke treguar një shkallë të lartë të vendosjes dhe dëshirës që ta kryejnë me vendosmëri krimin e synuar, dhe ishin në pozitë ta zmbarsin reagimin e mundshëm të viktimave,
- Viktimat kishin ra në pritë dhe ishin ekzekutuar në mënyrë brutale, duke u qëlluar me breshëri plumbash nga dy armë automatike, pa pasur mundësi të iknin ose mbroheshin.

Duhet të shtohet se edhe Besnik Hasani edhe Shpend Qerimi në kohën kur është kryer krimi kanë qenë policë.

Sipas një pikëpamje subjektive, kjo e zmadhon peshën e seriozitetit të sjellje së tyre. Si zyrtarë publik, ata kanë pasur një detyrë më të madhe për zbatimin e ligjit në përgjithësi.

Duke marr parasysh të gjitha elementet dhe duke pasur në mendje që për një vrasje të rëndë ligji përcakton dënim ndërmjet dhjetë vite në minimum dhe katërdhjetë vite në maksimum, trupi gjykues e sheh të arsyeshme të shqiptoj një dënim prej tridhjetetë viteve (33) burgim për veprën penale të vrasjes së rëndë dhe dhjetë (10) vite për veprën kriminale të vrasjes së rëndë në tentativë. Paneli vlerëson se dënimi real për kryerjen e veprës penale të mbajtës së paligjshme të armëve është dy vite. Kjo duke pasur parasysh faktin se posedimi ishte i një natyre të veçantë kualifikuese, pasi që të pandehurit kishin planifikuar përdorimin e armëve dhe në mënyrë efikase kanë përmbushur aksionet e planifikuara.

Dënimi unik për të tri veprat penale është tridhjetetë vite (33).

#### **4.2. Avket Vishi**

Duhet të merren parasysh këto elemente.

Së pari, i pandehuri nuk ka të dhëna kriminale më herët.

Intensiteti dhe kohëzgjatja e mbajtjes së armëve nuk ka lidhshmëri të veçantë. Qëndrimi i të pandehurit gjatë gjithë procedurës kriminale ishte korrekt dhe me vend, duke mos ngritur çështjen e disiplinës gjatë seancave dëgjimore.

Prandaj, trupi gjykues është i mendimit se një dënim financiar (i masës relevante) mund të mjaftojë që t'i përmbush nevojat lidhur me imponimin e dënimit.

Për këtë arsye dënimi financiar prej 5.000€ do caktohet kundër Avket Vishit, pagesa të bëhet brenda 3 muajve pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm dhe zëvendësimin me burgim korrespondues në rast se pagesa nuk kryhet me kohë.

Kryetari i trupit gjykues  
Ferdinando Buatier de Mongeot

Anëtarët e panelit  
Arkadiusz Sedek  
Hajrie Shala

Procesmbajtësi  
Sonila Macneil

#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) dite prej ditës kur kopja e aktgjykimit u dorëzohet palëve, në bazë të Nenit 398 para 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Ankesa dorëzohet në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së qarkut në Prishtinë.

Ankesa duhet të njoftohet brenda 8 dite nga dita e aktgjykimit.